REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

ALBANIAN POST

Nr. 45

MAJ / MAY 2022

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



04 Flora Osmani...

08 Marseos Selimaj...

06 Aqif Neli...

19 Gazmend Cufaj...

EMRI MAJ NË GJUHËN SHQIPE

Maji është muaji i pestë i vitit në Kalendarin Gregorian dhe është njëri ndër shtatë muajtë me 31 ditë.

Emri Maj në gjuhën shqipe supozohet të vij nga mitologjia e grekëve antik. Maia në mitologjin greke ishte perëndi e cila në mitologjinë Romake krahasohet me perëndinë e "të mirave" Bona Dea. Festa kushtuar kësaj perëndie në Romën antike mbahej në kohën e këti muaji. Festa më e njohur e këtij muaji ndër shqiptarët është 1 Maji - Dita e punëtorëve (Dita e proletaratit) e cila në kohën e sistemeve komuniste në territoret shqiptare kishte një rëndësi të veçantë. Gjithashtu festohet si një shtysë nga koha e monizmit dhe 5 Maji, si Dita...

(vijon në faqen 02)

24/7 orë linjë emergjence

07878335000

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të trafikimit njerëzor

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

(vijon nga faqja 01)

...e Dëshmorëve.

Më datë 6 Maj, në shumë treva Shqiptare festohet dita e "Shën Gjergjit" festë kjo shumë e vjeter me siguri qe nga koha e paganizmit . Me anë të kësaj feste , shënohet fillimi verës, për dallim nga "Shën Mitri" fillimi i dimrit. Në të kaluarën janë kryer shumë rite duke përfshi, mbledhjen e degëve me gjethe të njoma dhe vendosja e tyre nëper hyrje të shtëpisë, ahurit etj. mbledhja e barishteve të ndryshme , me të cilat janë ushqyer kafshët, me qëllim që te jenë sa më të shëndetshme.
Të gjitha këto ceremoni janë kryer në natën e "Shën Gjergjit",me 5 Maj. Dita e "Shën Gjergjit" fetsohet me "sillën" (Zemra, një shujtë në mes të mëngjesit dhe drekës) apo drekën solemne. Për atë drekë solmene, gatuhet kryesisht Mish qengji me tavë, me oriz dhe spinaq, Pite , dhe gjithsesi "Përshesh" (bukë te ndarë ne copa të vogla dhe të njomur në ndonje lëngë) me qumësht dhe bukë misri. Në të kaluarën vjazat kanë festuar shumë gjatë ardhjen e "Shën Gjergjit" Me këngë me def e me lojëra të ndryshme , kjo ka zgjatur edhe deri në dy javë,e cila është përmbyllur me natën e "Shën Gjergjit" ku vajzat kanë dalë në natyrë nëpër fusha për të mbledhë degë me gjethe të reja dhe lule. Ndërsa në ditën e sotme nata e "Shendgjergjit" festohet duke dalë në shëtitje, kryesisht në ndonjë park apo "Tyrbe", ku gjatë kesaj kohe vijnë shumë lojëra të ndryshme.

Maji - Muaji i Zojës së Bekuar

Kisha Katolike muajin maj, ia kushton nderimit të Virgjërës Mari, Nënës së Zotit. Besimtarët katolikë gjatë këtij muaji vrapojnë tek Nëna, duke lutur rruzarën, Litanitë e Zojës, e asaj ia besojnë jetën e tyre personale e familjare. Maji është kohë lutjeje e bashkimi më të ngushtë me Nënën tonë qiellore, e cila na çon tek Jezusi. E Papa na thërret në këtë muaj të lutemi në mënyrë që sipas shembullit të Vigjërës Mari, çdo i krishterë, të jetë përherë i kujdesshëm ndaj shenjave të Zotit që përjeton e has në jetën personale, dhe Fjalën e Zotit ta ketë prijëse jete.
Muaji i majit, vetvetiu, i është kushtuar Zojës, sepse është muaji i bukurisë, muaji i shpërthimit të jetës e asnjë krijesë nuk është më e bukur se Maria; asnjë krijesë nuk i ka kënduar jetës si Maria. Prandaj muaji i majit është muaj marian.

Si lind përshpirtëria për Zojën e Bekuar?

Devocioni për Zojën e Bekuar lind nga vetë historia e shëlbimit, është vepër e vetë Zotit. Shën Luka ungjilltar i paraprin tregimit mbi Lajmërimin e Zojës nga Engjëlli Zotit me disa fjalë, që kanë një kuptim jashtëzakonisht vendimtar. Thotë Ungjilltari: "Engjëlli Gabriel qe dërguar nga Zoti në një qytet të Galilesë, të quajtur Nazaret, tek një virgjër me emrin Mari." Kjo shtesë ka rëndësi vendimtare: na tregon se është Zoti ai që e dërgoi Engjëllin. Prej këndej, edhe se është Zoti ai që e zgjodhi Marinë. Ishte Zoti ai që trokiste te derën e zemrës së Marisë; e cila u hap para Hyjit e që atë çast Maria u bë bashkëpunëtorja më e madhe dhe më e ngushtë në planin e shëlbimit. Maria është vazhdimisht pranë Jezusit, nuk ndahet kurrë nga ai. Prandaj themi se Maria na merr për dore e na çon te Krishti.

Cilat janë elementet kryesore të muajit marian?

Pjesëmarrja në meshë dhe në Litanitë që thuhën në nder e lavd të saj. Por, çasti më i rëndësishëm i muajit maj duhet të jetë ai i rizbulimit të lutjes mariane e posaçërisht i lutjes së Rruzares në familje. Mund të themi se dikur Rruzarja ishte një element i domosdoshëm për jetën e përditshme të familjes së krishterë. Familjet e tona e kanë pas traditë të mblidhen çdo mbrëmje për të thënë Rruzaren Shenjte. Kur nuk kishte televizor, madje as dritë; gjithsesi nën dritën e kandilit familja ndjehej mrekullisht e lumtur. Sa binte terri, këmbanat e Kishës këndonin 'Ave Marinë', e familjet ishin përplot me Zotin, derisa i luteshin Zotit së bashku me Zojën e Bekuar.
Për ta thënë mirë Rruzarën është e nevojshme që në shtëpi të ndjehet atmosfera e lutjes. Lutja nuk vjen vetvetiu. Nëse në shtëpi ndjehet fryma e fesë, është e lehtë të krijohen kushtet e nevojshme për të thënë me fe e gjithë zemër Rruzaren. P sh në errësirë duke ndezur ndonjë qiri, dhe duke lëshuar ndonjë muzikë të lehtë instrumentale, meditative. Por para së gjithash duhet që të mblidhen të gjithë anëtarët e familjes së bashku, sepse Rruzarja është e bukur, e fuqishme, kur e thotë mbarë familja së bashku, kur i luten Zotit të gjithë një zëri. Duke lutur së bashku Rruzaren, ndjehet zëri i popullit të Zotit, familja bëhet një gjë e vetme me Të, ndjehet misteri i Jezusit të pranishëm në mes të atyre që janë mbledhur në emër të Tij. Mbretëresha e Majit – lutu për ne!

GUSTO ITALIAN

„Gusto 272 Italian“ Restoranti i munguar në Londër.

Gjithsejt: 110 persona. Dy salla moderne.
Salla kryesore: 75 persona, për festa, gëzime, ditëlindje, fejesa dhe martesa, takime të ndryshme.
Salla e dytë: 35 persona, për të gjitha okazinet festive.

„Gusto 272 Italian“ kombinim i përsosur: tradicional, modern dhe me porosi.

Kualitet Cilësi Konkurrues Garanci Siguri Pastërti Respekt

Adresa: vetëm dy minuta larg nga stacioni i trenit Preston Road,
272 Preston Road; Harrow; London; HA3 0QA

Tel: 020 8904 7775
Email: info@gustoitalian.co.uk

KARRIERA IME SOT KOMBINON DY NGA PASIONET E MIA TË MËDHA

Pronarja e drejtuesja e "Gusto 272 Italian" Flora Osmani thotë se "Pas vitesh punë të palodhur, hapa restorantin "Gusto 272 Italian" dhe shumë shpejt u bë një sukses me paraqitje të shumta që pasuan në media. Më kanë pyetur shpesh për vendin e grave në botën e kuzhinës dhe çfarë mund t'i pengojë gratë. Mendoj se mungesa e përfaqësimit të grave në mediat ushqimore, veçanërisht mungesa e grave të përfshira në listat e industrisë së shefave të kuzhinës "më me ndikim" ose "më të fuqishëm" dërgojnë mesazhe të fuqishme."

Më tej ajo thekson se duke u rritur në vitet më të rëndësishme të jetës sime me një nënë që ishte një kuzhiniere e jashtëzakonshme në shtëpi dhe një baba që i pëlqente të na këshillonte mjaft mirë, më pas me një bashkëshort mjaft punëtor dhe shumë i dhënë mbas ushqimit cilësor unë dhe njerëzit e mi ramë në dashuri me ushqimin e mirë, pak e dija se kjo do të më ndihmonte të më jepte përparësi kur të dilja në këtë front, që tashmë e drejtoj me pasionin më të madh.

Karriera ime sot kombinon dy nga pasionet e mia të mëdha, respektimin me cilësi të lartë me kualitetin dhe disiplinën në angazhim. Unë jam tashmë gruaja që kam thyer disa mite, dhe që jam tashmë vetvetja, dhe gjatë kohe kam ndjreë më shumë se kurë atë që mund të bëjë një grua pasionante, një grua e zonja dhe e përkushtuar, kur ka gjithnjë pranë një familje shembullore që e mbështet shumë.

Vite më parë mendova se jeta ime ishte harruar. Më vonë do të ngazhohesha në mjaft drejtime. Do të bëhesha një grua që do të jepte dhe një kontribut në komunitet, dhe më gjerë në Londër. Ky mjedis macho më la në buzë me ankthin dhe depresionin tim të së shkuarës, tani kam gëzimin më të madh, kam familjen, kam "Gusto 272 Italian" dhe stafin emrekullueshëm.

Mungesa jonë e plotë e së shkuarës, mbështetja tek ndjesia e traditës është në fakt mjaft çliruese, frymëzimi mund të godasë një ditë dhe të veprohet në tjetrën. Dhe nëse klientët e pëlqejnë, ajo qëndron. Çdo pjesë e asaj që bëjmë është e frymëzuar nga cilësitë femërore të kujdesit dhe edukimit dhe nuk do të jetë çudi që përbërësit e mirë janë një pjesë kyçe e etikës sime; miell organik, bulmet, fruta dhe perime të furnizuara në vend – aq vendas sa që ekziston edhe një sistem shkëmbimi me kopshtarët lokalë dhe mbajtësit e alotmenteve.

Jam vërtet krenare për ekipin tim që vazhduam të mbanim gjallë një emër në këtë lartësi, duke ushqyer komunitetin, duke u dhënë atyre në nevojë dhe duke u dhënë pako ushqimore për familjet e uritura me fëmijë.

"Gusto 272 Italian" është tashmë një model dhe një simbol integrimi në rritje. Kjo falë zonjës së nderuar Flora Osmani, që di si të sillet dhe si të ndërtojë një biznes të nivelit të kërkuar. Dhe kështu po e rithem se karriera ime sot kombinon dy nga pasionet e mia të mëdha, të qenit një nënë shembullore me fëmijë të edukuar dhe një biznesmene me një restorant të mirëfilltë e tejet të kërkuar e frekuentuar.

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

24/7 orë linjë emergjence

07878335000

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

AQIF NELI INTELEKTUALI DHE BIZNESMENI I SUKSESSHËM SHQIPTAR NË BM

Intelektuali dhe biznesmeni i suksesshëm shqiptar Aqif Neli është prej kohësh një nga modelet e referimit të suksesit dhe integrimit për shqiptarët në MB. Ai dallohet për kontributin e shquar dhënë në fushën e humanizmit ndaj komuniteti shqiptar dhe njerëzve në përgjithësi, sponsorizimin e aktiviteteve dhe ndihmën për Shkollat shqip në Mbretëri të Bashkuar dhe për ngritjen e vazhdueshme të figurës shqiptare në mjedisin britanik. Ai është dalluar dhe nderuar gjthnjë nga institucionet britanike përkatëse për punën dhe rezultatet e larta me kompaninë e tij "AN Construction Solution Limited". Ai gjithnjë është gjithnjë në mesin e të punësuarve të shumtë të tij shqiptarë e të huaj, në mesin e fronteve të reja të punës. Biznemsnein e dalluar shqiptar Aqif Neli e gjen gjithnjë në krye të një paneli, ku ai ka pikënisjen parësore të punës me tre elementët kryesorë e të domosdoshhëm të një suksesi: Shëndeti dhe siguria, Produkti dhe Cilësia. Gjithashtu Aqif Neli dallohet dhe për kontributin e tij të vazhdueshëm në ndihmë të integrimit të komunitetit shqiptar në Britaninë e Madhe, duke qenë Kryetar i Bordit të shoqatës shqiptare "Mother Tereza – Albanian Union".

Aqif Neli, intelektuali dhe biznesmeni i kualifikuar i fushës së ndërtimit, në jo pak raste ka merituar fjalët dhe respektin më të lartë komunitar dhe britanik në fushën ku ai tashmë operon me kompaninë e tij prej vitesh. Në një ambient pune ku diskursi i gjërave rrek estetiken e të gjithë panoramës dhe me një modesti të shtjellët respekti kupton se njeriu i suksesshëm mësohet nga udhëtimi i tij, jo nga destinacioni. Mësojmë se si arriti atje, pikërisht në majën e suksesit, duke kuptuar se sa vështirësi i është dashur të kalojë e kapërcejë me durim e përkushtim për të arritur ku është sot me një stendë që flet vetëm për certifikata, vlerësime, dedikime dhe mbi të gjitha për rezultate e cilësi. Në këtë kontekst gjithkush ndjehet krenar dhe mëson mëson mes arritjeve dhe vlerësimeve se çfarë bëjnë njerëzit e suksesshëm si intelektuali i plotësuar Aqif Neli.

Për Aqif Nelin është jeta që nis larg në Atdhe me bukuritë e memorjet mes shtatë fëmijëve vëllezër e motra të një familjeje me gene patriotike dhe disiplinore atdhedashëse, ku u rrit vetë protagonisti, që babai i tij Nel dhe nëna i rritën të mbeten modele për të gjithë. Aty, atij i kujtohen mjaft gjëra që ushqyen vizionin e tij që në fëmijëri, kur babai i thoshte të shihte më së miri udhën e vet. I kujtohen të gjitha dhe në disa raste edhe përlotet. E ndjen se ende ka për të shkuar më tej mes këshillave të vlefshme familjare. E ndjen se ai tashmë duhet të shkojë në atë që ka mbajtur në zemër e në mendje.

Rezultatet nisin qëkur dhjetat e shoqëronin përditë në shkollën e vendlindjes dhe më pas e ngritën deri në nivele të larta specializimesh. Studenti i shkëlqyer, kandidati për pedagog në një nga universitetet më prestigjioze të kohës, i mirëspecializuari në një vend mik të NATO's ndoshta dhe deri tek niveli më i lartë i kualifikimit Degre në fushën e konstruksionit në Britani të Madhe etj. Duke shkuar më tej të gjitha që janë në dosjet e vlerësimeve të kompanisë, janë faktor dhe rezultat i gjatë dhe i ndjeshëm. Pasionant, nuk është vetëm një pjesë që e shtyn tek suksesi biznesmenin Aqif Neli. Janë shumë arsye që nisin nga elementi më i thjeshtë, njeriu intelektual i specializuar në personel, rezultatet e larta, puna si manaxher, kontraktor, disa nga pasionet që e kanë shtyrë në jetë jo vetëm që të jetë i suksesshëm, por dhe një model komunitar. Kur flasin për punën ose jetën e tij, fytyra e tij ndizet dhe na tregon se ai vetë nuk mund të flasë për veten, por për pasionet e tij. Ai është si të gjithë ata që e duan atë që bëjnë. Ata kanë një sens të fortë të përkatësisë në punën e tyre, familjeve të tyre në çdo sferë të jetës. Ndaj dhe kanë edhe familje model. Në rastin konkret një dashuri e largët bashkëshortore dhe një familje me dy fëmijë të talentuar dhe model në jetën e tyre. Bashkëshortja e tij, doktoreshë Vali, natyrisht është një pjesë e suksesit që bashkohet përtej pasionit të kësaj familjeje të nderuar komunitare.

Ai e nisi me punën, përkushtimin, gjuhën angleze dhe më tej me marrjen e një qëndrimi pozitiv për suksesin e sotëm të "AN Construction Solution Limited", si një kompani model dhe mjaft e vlerësuar. Më parë ishin pedagogët e tij në Atdhe dhe këtu në BM që shihnin tek ai pozitivitetin mbi të cilin edhe e vlerësonin dhe e propozonin më lart. Integriteti, është themeli ku "AN Construction Solution Limited" ka një nga atributet më të vlerësuara të një personi të suksesshëm.

E fundit në këtë shkrim në disa pika të tjera është terminologjia "Mirënjohje". Njerëzit e suksesshëm, sikurse është tashmë z Aqif Neli prej disa vitesh, janë gjithmonë falënderues për marrëdhëniet, jetën e tyre, mirëqenien e tyre, familjen, punën e tyre dhe lumturinë e tyre. Ata kthehen pasi janë falënderues për atë që kanë marrë, duke qenë humanë e duke kontribuar pa u dukur, pa u marë vesh në ndërtimin e disa banesave për njerëz të varfër dhe për mjaft bashkëvendas të tij në Atdhe, sikurse ishte rindërtimi i shtëpisë së shkatëruar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të qytetarit nga Laçi, Vlash Prenga. Për këtë Bashkia e këtij qyteti i ka akrduar një Mirrënjohje, që në fakt ajo është në numrin e mjaft të tjerave që ai ka marë pas konsideratës së tij humane për mjaft njerëz në nevojë. "Kur është hera e fundit që falënderove dikë?", vjen pyetja e fundit për Aqif Nelin ishte kur ai u vlerësua Ambasador i Paqes në Londër, nga Federata e Paqes Universale (FPU), në një ceremoni solemne e festive, ku ai midis disa të tjerëve u vlerësua për arritje e merita të tij përkushtimore e përmbushëse në kriteret e përcaktuara nga kjo OJF Ndërkombëtare me Status Special Konsultativ pranë Këshillit Social-Ekonomik në OKB.

POMODORO

KUALITET-CILËSI-RESPEKT

PIZZA
BUY 2 GET 1 FREE

POMODORO
Pizza, Pasta & More

POMODORO
Pizza Restaurant
Italian Cafe'

NOW
OPEN

POMODORO
Pizza, Pasta & More

POMODORO M12 RESTAURANT

(ADRESA: 12 High Street, Hornsey, London N8 7PB

Festa familjare, takime rinore, ditëlindje,
Okazione të tjera

“POMODORO” NJË MODEL QË DUHET SHIJUAR

Të emigrosh është një gjë. Tjera është si të përshtatesh në emigrim. Si të bëhesh ai që duhet të jesh në kushtet e emigrimit. “Kur fillova, të mendoj për të hapur një biznes të tillë nuk ishte e lehtë”, thotë Marseos Selimaj. “Ishte një aksion i paparë.” Kuzhinierët duhet të ishin në plan të parë, ideja në anën tjetër, modeli, angazhimi, përkushtimi…, eh, dhimbje koke”, thotë ai. “Kombinimi i kohës së Brexit dhe pandemisë ka qenë si një cunami që godet industrinë e tillë. Londra është një Metropol. Stafi evropian, veçanërisht ata pa familje këtu, kanë shkuar në shtëpi.” Restorantet kanë ndryshuar stil. Edhe Marseos i kishte menduar mjaft mirë të gjitha.

Një bisedë me familjen. Një vendim me babain e tij të mrekullueshëm, e gjithnjë përkrahës të familjes dhe ideve të tilla dhe koha nuk priste. “Njerëzit hidhnin CV-të e tyre gjatë gjithë kohës. Kohët e fundit kam bërë mjaft kërkesa për kuzhinierë dhe nuk kam pasur asnjë përgjigje. Dhe kështu iu nënshtruam vetë të gjitha procedurave. Ky është një ndryshim i madh gjeografik dhe emocional; njerëzit nuk duan më të punojnë orë të gjata në kuzhinë larg shtëpisë, por ne e bëmë këtë vendim dhe projekt që na është bërë tashmë një model.”

Marseos u transferua në Londër pak kohë më parë, në një moshë relativisht plotë vrull dhe ide: “Ne do të vizitonim vende të ndryshme biznesesh të ngjashme kur isha i ri dhe mendoja në vetvete për projekte të ngjashme, kështu që një gjë e tillë ishte gjithmonë në radarin tim. Vizitova një mik në Londër dhe u dashurova me kulturën, historinë, muzikën, futbollin britanik. Unë kurrë nuk shkova në shtëpi mendjebosh. Kërkoja më tej në metropolin e pafund britanik. I shihja disa që

silleshin kot dhe ankoheshin dhe më dhimbte koka. Unë dhe familja ime bënim nga dy punë dhe kështu e nisëm ndryshimin.”

Pasi ka punuar fillimisht punëra të ndryshme, ai u kërkoi dhe kërkonte më shumë nga vetja, pasi kishte tashmë më shumë ide në kokën e tij. “Si emigrant, gjuha është një pengesë për punë,” thotë ai, “por të qenit në restorante ishte ajo që dija. Puna më përshtatej derisa dija mjaftueshëm për të folur me klientët dhe për të marrë porosi.”

Tryezat e pastra të “Pomodoro”, kualiteti i picave dhe cilësia e ushqimit që gatuhet, produkti i ndryshëm i shërbyer me kulturë, u bënë shpejt ushqimi më i vlerësuar i zonës në High Street, Hornsey të Londrës, pasi ai hapi një mënyrë të re të shërbimit dhe inkurajimit të klientëve të lodhur që të merrnin tre pica, një prej të trijave ishte falas. Kështu kënaqej dhe pjesa tjetër e familjes. Kur themeloi “Pomodoro”, një shenjë italiane për kulturën që pasonte picat tejkaloi limitin, duke shërbyer kuzhinë të kombinuar mes disa kulturave, pa harruar dhe tradicionalitetin shqiptar, që Arjani, i përkushtuari dhe i dashuri i zemrës së tij e bën këtë me kënaqësi dhe përkushtim. E jashtme e saj piktoreske britanike përgënjeshtron ngjyrat dhe aromat e një këndi tipologjik dhe mjaft tërheqës, simpatik, gjithnjë në përmirësim, që do të gjeni brenda.

Ushqimi i “Pomodoro” është i zhytur në trashëgimitë e vlerave të tilla që ushqejnë përditë idetë e familjes Selimaj. Ai thotë: “Familja ime ka traditë biznesi. Gjyshja ime ishte mjaft e njohur në Elbasanin tim të dashur dhe kishte një emër mjaft të respektuar atje në shërbimin kulinar. Tradita shkon tej dhe mjaft larg në historinë e një traditë të gërshetuar gollobordase dhe elbasanase. Historia shkon në një qytet ku Romakët sollën ullinj dhe agrume; arabët sollën erëza; turqit erdhën për të ndërtuar besime dhe kulte, duke sjellë kafe dhe bakllava; dhe, në fund, tradita e kultura tipike që shkon deri tek byreku dhe thjeshtësia e ushqimit të shijshem shtëpiak. Të gjitha kulturat që formuan sythat e mia të shijes ekzistojnë në menunë time dhe idetë e mia. Unë jam rritur dhe do të ideojë më tej këtë kulturë dhe këto ide.”

Idetë përfshijnë jo vetëm atë që ai gatuan dhe servir për klientët, por dhe mendimet për arkitekturën dhe amjen e lokalit:. “Babai im gjithnjë është modeli më mbështetës. Dhe ai që e njëh Arjan Selimajn dhe familjen e tij të mrekullueshme gjithnjë mendon më të mirën.”. “Është bekimi i fëmijërisë sime. Kur erdha këtu në Londër, nuk doja të isha thjesht një facebooks dhe një aventurier, doja të zbuloja dhe të mësoja. Vetë biznesi im nuk ishte kurrë ndoshta dikur pjesë e planit, por tani është jeta ime. Një djalë i panjohur postoi në Tëitter për ushqimin tim vitin e kaluar. Nuk e kisha menduar kurrë këtë që do të pëlqehej kaq shumë.”

“Pomodoro” tashmë po udhëton në rrugën e vetë. Është një model. Një arsye më shumë për të treguar se si funksionon jeta me ide, me angazhim, me përkushtim. Ky është Marseos Selimaj, kjo është familja e Arjan Selimaj, që tashmë kërkon nga të gjithë të hidhen sytë atje, e të shikojnë më shumë se sa mund të shohin në realitet. “Pomodoro” tashmë ju mirëpret për ditëlindje, dasma, gëzime, e për evenimente të ndryshme.

GRATË SHQIPTARE TEK "ZEMRA E BALLKANIT"

Shkrimtarja që ka shkruar librin "Zemra e Ballkanit" është njohur si shkrimtare greke, ndërsa në një rrëfim të saj të hershëm që ndodhet në arkivat britanike, ajo mbron shqiptarët, flet me krenari për ta, sidomos për gratë shqiptare. Demetra Vaka mban emrin e lashtë të hyjneshës së plleshmërisë të tokës dhe e bujqësisë, që njihej si e bija e Titanit Kron dhe gruas së tij Rea. Zonja Demetra Vaka, një vajzë greke, e cila shkoi në Amerikë dhe u martua atje, sapo ka botuar një libër të quajtur "Zemra e Ballkanit" (1917), ku tregon përvojat e saj kur eksploroi atë rajon të egër me një vëlla që vepronte si komisioner për Qeverinë turke. Ajo flet për Shqipërinë e asaj kohe dhe thotë se në Shqipëri "gruaja më në sy të publikut, nuk është ajo që figuron mes të pranishmëve dhe kryeson çajrat e shegës." Në atë material shkrimtarja flet për gjakmarjen shqiptare, të cilën e trajton nga biseda origjinale, që ajo ka bërë me një nënë shqiptare, që ushtarët turq ia kanë vrarë burrin, ndërsa biseda sillet nga bashkëbisedimi i kësaj nëne shqiptare me djalin e saj të vogël, që në sy të shkrimtares i kërkon të bëjë realizimin e gjakmarrjes për të shoqin dhe të atin e fëmijës. Sidoqoftë, në materialin që sjellim më poshtë po mundohemi të qasemi tek thelbi i tij, duke e dhënë ashtu sikurse mund të shqipërohet saktësisht me titullin mjaft domethënës "Gjakmarja shqiptare":

"Në Shqipëri, gruaja më në sy të publikut, nuk është ajo që figuron mes të pranishmëve dhe kryeson çajrat e shegës. Respekti më i madh i jepet zonjës që mund të mburret më së shumti në kondakun e pushkës së saj. Biseda e zjarrtë e mikpritësve të saj me djalin e tyre të vogël tërhoqi vëmendjen e saj:

"Po i thosha Stathe se je nga Qeveria dhe ia tregoja këtë. Ajo tregoi një njollë të errët në mur.

"Çfarë është ajo?"

"Ky është gjaku i babait të tij. Atë e vunë në qoshe 10 ushtarë. Ai vrau gjithçka mundi, por ata e përfunduan". U drodha. "Ti thua se njeriu yt u vra para syve!"

Ajo më shikoi me neverinë më të madhe. "Po të isha këtu, do të ishte një luftë e barabartë, 10 ushtarë turq me dy shqiptarë, dhe burri im do të jetonte sot. Ai vrau gjashtë dhe sakatoi një para se ta mbaronin. Unë po i thosha Stathes se atje ishin katër ushtarë të Qeverisë që ju përfaqësoni, të cilët duhet të vdesin për të atin, pjesa tjetër që do të vrasë do të jetë për Shqipërinë".

"Nuk do ta pastroni këtë vend?"

"Jo derisa Stathe të marrë gjakun që na është borxh."

U ula e lodhur në një gur të ulët që shërbente si stol, duke u ndjerë mjaft e dobët.

"A keni mbytur, apo vrarë ndonjë turk?" pyeta për momentin.

"Çfarë mendoni se jam uloke? Të gjitha ne femrat, luftojmë kur meshkujt janë në mal dhe ne nuk habitemi. Këto janë armët e mia".

Shkrimtarja në librin e saj sqaron se në kohën kur ajo flet Shqipëria ishte e lakmuar nga Austria dhe Italia, të dyja anëtare të Aleancës së Trefishtë, dhe për të shmangur dëshirat e tyre, Franca dhe Anglia synonin të ruanin integritetin e Perandorisë Osmane, pa marrë parasysh sa sa gjak lau tokën e Shqipërisë, apo të ndonjë pjese tjetër të Ballkanit.

Shkrimtarja shprehet "Duke ditur tashmë se cilat do të ishin rezultatet praktike të kërkimeve tona, ajo që më interesoi personalisht ishin gratë e Shqipërisë; dhe meqenëse, pas largimit nga Shqipëria, duhet të kalonim gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e Ballkanit, do të kisha mundësi të studioja gratë e Malit të Zi, dhe ato të Serbisë e më tej."



DEMETRA VAKA

Whose new book, "A Child of the Orient," has just been published by John Lane (7s. 6d. net)

DY GËZIME NE NJË DITË PËR RASIM MUSA AHMATIN

Eshihni! Rasim Musa Ahmati hezitonte të rikthente atë që ia kishte dhuruar Zoti, si talent të tij, ndërsa vitet dhe kohërat ia kishin akumuluar, ndaluar dhe krijuar anomalinë e hezitimit. Tani ai është ndryshe. Të dielën e 3 Prillit 2022 e shënoi me dy gëzime në ditë. Festoi 60 vjetorin e ditëlindjes së tij dhe ardhjen në dritë të botimit librin e tij të parë me poezi "Pa asnjë kusht". Kështu ditë të tëra ai mezi priste të shkonte në këtë ditë festive në një lokal që është pronë e biznesmenit shqiptar, Gëzim Aliaj dhe vendosi për t'u ulur në vendet ku ishin shokët e tij më të ngushtë, që nga fëmijëria e deri në ditën që ai mbushi plotë gjashtëdhjetë dhe nxori në dritë librin e tij të parë, dhe për t'u përgatitur për të kaluar një ditë të mirë dhe pastaj të dëgjonte tërë ato fjalë të mira e të mbajtura strukur në memorjet e shokëve të fëmijërisë, shkollës, fqinjësisë, punës në minierë, atyre që kishte në vitet e pas 90-tës, dhe atyre që iu bashkuan në udhën e emigrimit në Mbretëri të Bashkuar.

Surprizat për këtë ditë me dy gëzime për Rasim Musa Ahmatin nuk kishin të sosur. Më entuziasti dhe më i angazhuari ishte padyshim Ermal Karakushi, vëllai i tij Neri dhe mjaft miq e shokë që e kishin sajuar më së miri këtë ditë festive të poetit, që tashmë kishte më shumë arsye të gëzohej në një festivitet të tillë. Në një përkujdesje në renditjen respektuese të uljes në sallën festive, ku dukej qartë një pankartë me shënimet përkatëse për të dy rastet që shënonin këtë festivitet, libri dhe ditëlindja, vinin shokët e tij të mirë Man Gjeci, Et'hem Sokoli, Ismet Kabashi, Rrustem Baraku, Feim Duraku, Sokol Laçi, Qazim Sokoli e me radhë.

Një dyshe që krijoi atmosferën mjaft festive në këtë ditë të shënuar për poetin Rasim Musa Ahmati, natyrisht i dha zjarr festës dhe urimet për këtë poet të ri nga Hasi, nuk pushuan së lexuari, madje ato erdhën edhe nga Atdheu, nga të afërm, miq, dashamirës që e ruan dyfish autorin. Urimet dhe fjalët e pjesëmarrësve shënuan një atmosferë magjike dhe tërhoqën vëmendjen e të gjithëve. U duartrokit mjaft, u festua dhe u këndua. Ishte një ditë mjaft interesante. Thuajse një ditë mjaft e shënuar që solli në atë mjedis raste dhe fakte mjaft interesante për autorin, demokratin dhe njeriun e përkushtuar. Ai u njoh mes të pranishmëve si demokrati me shpirt të madh që hoqi nga zyrat e minierës fotografinë e diktatorit që në vitin 1989. Një guxim i madh i demokratit me shpirt që kërkonte lirinë dhe dashurinë për Njeriun e Lirë.

Kjo është në thelb edhe tërë tematika e poezive në librin e tij, ku mjaft tema u trajtuan dhe u diskutuan në atë sallë plotë me miq e të ftuar që dëgjuan komentin dhe leximin e poezive të poetit nga Hasi Rasim Musa Ahmati.

Takimi i parë

Kur e takova për herë të parë ishte një eveniment njerëzish të thjeshtë që i bashkon e njëjta ide dhe dhimbje në emigracion. Qielli sipër meje, ishte i mbyllur teksa retë e shiut të errët, ogurzi, por magjepsëse ishin afruar, duke u mbledhur së bashku në një këshill. Një këshill resh, që të ndjekin. Të ndjekin dhe nuk të lënë rehat dhe në tokën e Tjetrit!

Ndërsa filloi të binte shiu, ndjeja se binin pika të buta, herë të ngrohta dhe herë të vogla. Ai ndiqte me titmin e vet, ashtu mendueshëm nën rudha fytyre të thjeshtë burrërore dhe shiu në hapësirën qelqore krijonte një vijë, që dukej se kaplohej nga sytë e të gjithëve në atë sallë në Barking të Londrës, si një rënie butësisht. Butësisht, por pa kujdes duke goditur tokën, duke e lagur në planin e pakuptueshëm ujor në vijën e pikave të shiut, që bëheshin rrëke.

Dhe ashtu me atë shi londinez në shoqërinë e atij Njeriu të thjeshtë, kisha marë mendimesh me vete dhe isha përhumbr iku. Sërrish në shi… mendoja dhe risillja ndërmend … Herë pas here, ndërsa shiu fiton forcën e tij, duke goditur tokën poshtë me më shumë shpejtësi dhe vrazhdësi në veprimin e stërkalave dhe ciflave të tyre, diçka humbet, struket. Ikën në ikje të tilla që vetëm të ujtat e kuptojnë.

Rrezet e dritës më të pastër, të dërguara nga dielli ndërsa shkëlqenin mbi qiellin që errësohej, të sillnin një ndjesi për nervin optik, një ndjesi për syrin. Në këto meditime tërësisht ia kalon grumbullit tëmemorjeve dhe e lë këtë skenë të shkëlqejë edhe më shumë. Pika të këndshme, të mbartura dhe të shtrembëruara nga era madhështore, më tej krijonin një melodi të bukur në dritaren e përthyer, ndërsa të përplasurat e ujëta, vogëlsirat, ata pra stërkalëzat iknin një nga një dhe ende më duket se fluturojnë në tërësinë e një bisede që dukej mjaft interesante.

Tani, ndërsa toka është plehëruar, jeta me siguri do të rritet nga rrezet e diellit.

Ashtu si pikat e shiut bartej nga era, mendja ime që angazhohej me këtë skenë, dhe më shpinte skenarë të ndryshëm që të dashurohem me atë tokë të bukur, të cilën e kisha shfletuar për disa minuta në përhumbjen time.

"Pak shi nuk do të jetë shkaku i trishtimit" – ndërhyri pikërisht ai. E quajnë Rasim Musa Ahmati. Është nga Hasi. Dhe vazhdoi mos i kujto trishtimet! Moskujtesa duhet ndonjëherë, pasi me të vërtetë në momente të caktuara ajo zhbiron. Vetë kujtesa është një kujtesë e momenteve të dashurisë që e bën më të lehtë përcaktimin. Kështu që ndaj e mbaj shikimin nga dritarja dhe shijoj motin. Shijoj…. Deri atëherë, qielli pastrohet dhe dielli shkëlqen përsëri.

Ai u përqëndra paksa dhe pëshpëriti me vete.

Nuk doja ta shpërqëndroja. Nuk doja atëherë. Atë ditë me shi londinez. Por sonte me një gotë raki shqiptare përpara në Wood Green me Rasim Musa Ahmatin fola gjatë për poezitë e tij, librin e ri të sapodalë nga botimi me një titull mjaft efikas, "Pa asnjë kusht" dhe për jetën e një djaloshi inteligjent që ia preu ëndërrat Spaçi dhe burgu i tij mizor, ku kishte të dënuar babanë e tij për mosbindje dhe mendime të kundërta me regjimin komunist. E kjo një renë e kuptueshme, pasi i Ati ishte cilësuar familje kulaku, nga koha kur babai i tij ishte tregëtar në zonën e vetë dhe njerëzit e quanin Aga në respekt.

Kështu e njohta…Rasim Musa Ahmatin. Dy takime me një gotë raki shqiptare: Një në shi, e një diell londinez…

PSE KAQ SHUMË SHQIPTARË PJESË E PAKICAVE ETNIKE BRITANIKE JANË KRENARË QË JANË BRITANIKË

Ndërsa qeveria përgatitet të publikojë përgjigjen e saj ndaj raportit të Komisionit të Racave, hulumtimi i ri nga British Future, Race and mundësitë në Britani: gjetja e bazës së përbashkët, ofron dëshmi të reja, të detajuara të qëndrimeve ndaj racës midis qytetarëve të bardhë dhe të pakicave etnike në MB. Gjetjet e tij, të paraqitura si provë në Komisionin e Garës, ilustrojnë pse të folurit për racën ndonjëherë mund të duket e vështirë, por gjithashtu identifikon bazën e përbashkët mbi të cilën mund të ndërtohet një axhendë pozitive për ndryshim. Veprimet për të trajtuar diskriminimin e CV-ve në punësim, për të luftuar gjuhën e urrejtjes në internet, për të nxitur përzierjen më të madhe në shkolla midis fëmijëve me prejardhje të ndryshme dhe për të promovuar një kuptim të përbashkët të historisë së Britanisë, duke përfshirë historinë e Perandorisë, ishin të gjitha çështje në të cilat minoriteti etnik dhe qytetarët e bardhë do të donin të shihnin ndryshim. Hulumtimi bazohet në dy valë kërkimesh përfaqësuese kombëtare të kryera nga Number Cruncher Politics, së pari në tetor 2020 (me një kampion prej 1000 minoritetesh etnike dhe 1,088 të rritur të bardhë në Mbretërinë e Bashkuar) dhe më pas në shkurt 2021 (me një kampion prej 2,000 minoriteti etnik dhe 1,5 të bardhë, të rriturit në Mbretërinë e Bashkuar).

U mbajtën shtatë grupe diskutimi në internet me pjesëmarrës të etnive të përziera nga Buckinghamshire dhe Hertfordshire; Cardiff; Glasgow; Leicestershire; Lewisham, Londra e Jugut; veri-lindja e Anglisë (Newcastle e Madhe, Sunderland dhe Northumberland); dhe Preston, Lancashire. Dhe të gjitha kanë thelbin e qasjes së faktit dhe asaj që shprehin elitat kulturore, 'nacionaliste' dhe politike.

Të qenit britanik sot shpesh paraqitet si një burim turpi nga disa nga elitat kulturore, 'nacionaliste' dhe politike. Ata citojnë krimet e Perandorisë Britanike si provë të historisë së kalbur të Britanisë. Dhe ata e karakterizojnë Britaninë sot si një vend racist, armiqësor, nga i cili çdo person që mendon drejt do të ishte i lumtur t'i shpëtonte. Siç tha një kontribues i gazetës britanike "Guardian", 'nocioni i

britanikitetit si një privilegj dhe burim krenarie ndihet absurd'.

Por jo çdo britanik ndihet kështu. Në fakt, ndryshe nga këndvështrimi i Guardianistëve për Mbretërinë e Bashkuar si një peizazh racist, neokolonial, shumë qytetarë të pakicave etnike janë mjaft të lumtur ta quajnë Britaninë shtëpi. Dhe ata e bëjnë këtë pa asnjë siklet apo turp. Në të vërtetë, studimi më i madh mbi racën i kryer në Mbretërinë e Bashkuar – raporti i Shoqërisë së Kuptueshmërisë, nga Instituti për Kërkime Sociale dhe Ekonomike dhe Instituti i Arsimit – zbuloi se "minoritetet etnike që jetojnë në Britani identifikohen më fort me "britanizmin" sesa homologët e tyre'. Një tjetër raport, nga British Future, doli në një përfundim të ngjashëm. Aziatikët në Britani, thuhet në të, "kanë ndjenjën më të fortë të përkatësisë britanike, me 70 për qind që thonë se i përkasin fort, krahasuar me 66 për qind të britanikëve të bardhë".

Edhe pse nuk ka në veçanti pika që konsiderojnë shqiptarët, pasi janë ende një komunitet i brishtë, për nga numri janë mjaft të vegjël në qasjen e numrave me etnicitetet e tjera, por shumica e tyre që jetojnë, punojnë dhe integrohen përditë në BM shprehen se janë krenarë që janë shqiptar-britanikë. Ata shprehen se janë krenarë që janë pjesë e një vendi mik që ndihmoi Kosovën në kohë krize dhe që iu gjend shqiptarëve në kohë të vështira, ndërsa mjaft të tjerë ende nga larg kanë mbetur tek termi i dikurshëm "Shqipëria londineze", si qasje e historisë.

Ndaj, ka një arsye të mirë pse shumë qytetarë të pakicave etnike, si unë, ndihen krenarë që janë britanikë. Kjo është për shkak se shumë prej nesh emigruan nga vende më pak të zhvilluara, shpesh të paqëndrueshme politikisht me një cilësi më të ulët jetese. Kam kaluar më shumë se gjysmën e jetës sime në Republikën e Shqipërisë dhe, që kur kam jetuar në MB, kam arritur vërtet të vlerësoj shumë që elitat e Britanisë duken të pavëmendshme, sundimi i ligjit, kujdesi universal shëndetësor, një infrastrukturë e zhvilluar, për të mos përmendur kulturën e pasur të Britanisë, trashëgimisë. Besoni apo jo, ka arsye të mira pse kaq shumë njerëz duan të jetojnë në MB.

Jo se do ta dinit se nga portreti i Britanisë i pikturuar shpesh në media dhe nga shumë aktivistë të privilegjuar zgjoheshin terma të frikshme. Ata flasin vazhdimisht për racizmin 'institucional' ose 'sistemik' të Britanisë dhe për fanatizmin e qytetarëve të saj. Historia britanike paraqitet në mënyrë të njëanshme si një përrallë e keqbërjes dhe shfrytëzimit racor. Dhe ka thirrje për rrëzimin e statujave dhe heqjen e dëmshpërblimeve historike. Le të flasim për shembullin e familjes sime. Erdhëm në një kohë të vështirë, por që nga fillimi familjarisht bëmë palë bulën e djersën me pikat e gjakut nga lodhja e shumtë mbi libra dhe arritëm të shkojmë në postdoktoraturë, doktoraturë, mastera dhe të jemi një familje me një shkollim dhe dukim të lartë. Tashmë me sensin e një profesionalisti dhe shkrimtari, shoh gruan time mësuese matematike në shkollat londineze, djalin e madh avokat, binjakët e mi, djalin në punë në një nga bankat më me emër, vajzën me një përvojë të madhe në BBC dhe kështu natyrshëm ndjej se jeta është ajo që përcaktohet vetëm me mund e me djersë, por dhe me mundësitë që të jep një vend...

ÇËSHTJA E TË KUPTUARIT (DHE KEQKUPTIMIT) TEK SHKRIMTARI VISAR ZHITI

Në vitin 1979, Visar Zhiti u përball me dënimin me heqje të lirisë së plotë, për një krijim, që u quajt "me gabime të rënda ideologjike dhe që nxinte realitetin socialist". Ishte përmbledhja me poezi "Rapsodia e jetës së trëndafilave" (1973), që me një gjyq të rreptë dhe grotesk në prill të vitit 1980 e bëri atë të vuante dënimin me 10 vjet burg, që pasi e çuan si fillim në burgun e Tiranës, ku atje grumbulloheshin të dënuarit, e nisin me një epërsi më të madhe në burgun famëkeq të Spaçit dhe, kur ky mbyllet si burg politik, e shpërngulën në një tjetër ende më të rëndë, në burgun e Qafë-Barit.

Për një poet që ishte deklaruar si i padëshiruar i sistemit, për poezitë e tij me "ekuivoke dhe gjuhën e Ezopit, të trishtuara, që nxinin realitetin…", aq më tepër që dhe babai i tij, Hekuran Zhiti, kishte pasur më parë një konflikt me autoritetet e vendit, pasi kishte qenë dhe vetë i dënuar, nuk kishte si të mos bëhej një nga të dënuarit politikë të diktaturës, si kundërshtar i atij regjimi. Krahas goditjes së armiqve të sistemit, kjo metodë shërbente, që pushteti i asaj kohe të frikësonte intelektualët e tjerë shqiptarë.

Çështja e të kuptuarit (dhe keqkuptimit) ishte bërë një çështje jete a vdekjeje. Një shkrim i disa muajve më parë, pjesa e të cilit është botuar dhe në disa gjuhë, gjurmon rrugën e Zhitit nga drita rinore që ai ëndërron studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër dhe në udhën e tij të mësimdhënies në qytetin malor verior të Kukësit tek errësira e burgjeve, ku shumë nga të burgosurit që ishin me të vdiqën nga keqtrajtimet, torturat dhe kequshqyerja, ose pësuan çrregullime mendore.

Rrjedhëjeta mes ëndrrave poetike

Visar Zhiti lindi në Durrës. Ai u rrit në Lushnjë, ku përfundoi shkollën e mesme në vitin 1970. Gjatë studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër, dhe më pas në detyrën e mësuesit në qytetin Kukësit, duke demonstruar një interes në fillim në vjersha, disa nga të cilat u botuan në revistat letrare, ai heshtazi, dhe vetë ndoshta nuk e kishte kuptuar, se ishte në një rrugë që donte të shkatërronte konventat e sjellshme të vargjeve prototipe të kohës.

Poezitë e tij që u botuan në revista letrare të kohës ishin sa moderne në formë, por aq dhe me një frymë të re në përmbajtje. Ai përdori gjuhë të zhdërvjellta dhe alegori mitike për të trajtuar çështje të që u trajtuan si të ngutshme nga qeverisja dhe drejtësia.

Abraziviteti i tij u bë një markë e papëlqyeshme e atyre që e ndiqnin nga pas dhe që kërkonin patjetër një shkak për ta dërguar në errësirë. Në një heshtje të detyruar, në lidhje me atë situatë, natyrisht ai me heshtje u thoshte, se depresioni juaj do të shfaqet tre herë në vit, derisa të mërzitet duke e prodhuar si faktorin më sublim të Njeriut të Ri e të lumtur socialist. Ai do të përmbajë çështje me interes, që për dashnorin e poezisë së lirë nuk kishte gjasa që koha me të cilën ishte destinuar poezia e asaj kohe të merrte forcë që t'i apelojë dikujt, përveç atyre që ishin të neveritur me gjendjen aktuale të letrave në monizëm.

Pas një kohe të gjatë në errësirën e Spaçit dhe të Qafë-Barit, Zhiti u lirua nga burgu në fillim të vitit 1987. Pushteti komunist nuk e lejoi më të punonte në profesionin e tij si mësues, por e "lejoi" për të punuar në një fabrikë të prodhimit të tullave në Lushnjë pa të drejtën e botimit dhe pa të drejtën elektorale. Kur nisën protestat kundër diktaturës dhe lëvizja për demokratizimin e vendit, ai ishte me të parët dhe u bë gazetar i opozitës. Mbas rënies së diktaturës komuniste në vitin 1991, ai arriti të shkojë në Itali ku bëri disa specializime për gazetari në Milano deri në 1992. Përmes një burse studimi nga Fondacioni Heinrich Boll, Zhiti shkoi në Gjermani në vitin 1993 dhe vitin e ardhshëm shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Udhët me pikëtakime ndryshe

Teksa e ndjekim këtë udhë mes dritës dhe errësirës së poetit Visar Zhiti, në një formë e në një tjetër, përveç aspektit "komunizëm" ne gjejmë një udhë të ngjashme me poetin e famshëm Ezra Loomis Pound.

Pound lindi në Idaho në 1885. Sapo Pound mbërriti në Londër nga SHBA (në 1908), me poezitë e tij ai kishte probleme me strukturat qeveritare dhe me drejtësinë. Suita e tij epike 50-vjeçare The Cantos ka mbi 800 faqe vargjesh në një përzierje të gjuhës angleze, provansale mesjetare, italiane, latine dhe mandarine. Nëpërmjet errësirës së saj, poezia e Pound ofroi një drejtim të ri radikal. Revista e tij Blast mbronte Vorticizmin (një variant britanik i futurizmit); prapa skenave, Pound organizoi grante për artistë modernistë të varfër si James Joyce dhe Ëyndham Leëis, ndërkohë që nuk ishte më mirë se ata. Hemingëay, Eliot dhe Yeats (ndër të tjerë) e konsideruan Pound një kritik të paçmuar. Ata i kërkuan atij të redaktonte shkrimin e tyre dhe ranë dakord për ndryshimet drastike që ai sugjeroi.

Në vitin 1945 Ezra Pound u përball me dënimin me vdekje. Pound mbërriti në Itali, ku u vendos në Rapallo në vitin 1924. Moody përshkruan se si poezia dhe politika e Pound u bashkuan në Italinë e Musolinit. Paundi filloi të fiksohej te ekonomia dhe bankat si rrënja e luftës dhe pabarazisë. Ai shkroi kanto të shumta duke distiluar pikëpamjet e John Quincy Adams mbi qeverinë, ekonominë Jeffersonian dhe teorinë bankare të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Shitjet e vëllimeve të njëpasnjëshme të The Cantos ranë në mënyrë dramatike. Edhe lexuesit e tij të paktë të përkushtuar pranuan se poezia e tij kishte nevojë për komente dhe përkthim të gjerë për të qenë e kuptueshme.

Pound, së bashku me shumë italianë, e panë Musolinin si një alternativë të fortë të qëndrueshme për të cenuar komunizmin dhe kapitalizmin e parregulluar. Përballë varfërisë dhe papunësisë së përhapur gjatë Depresionit të Madh, fashizmi (veçanërisht në formën e tij italiane) dukej një mënyrë e tretë e dobishme. Antisemitizmi nuk luajti një rol në politikën fashiste italiane deri në vitin 1938, nën drejtimin e Gjermanisë naziste...

DISKURSI I DASHURISË TEK "DRITARET E SHPIRTIT"

"Dritaret e Shpirtit" është titulli i romanit më të ri të shkrimtares Nexhi Baushi, ku fjala "dashuri" jo vetëm si nocion, por dhe si një diskurs më vete zë një hapësirë të madhe në të. Është përmendur e shtjelluar në mënyrë të thellë narrative "dashuria" me të gjitha përmasat e saj, aq sa të pesëdhjetë përdorimet ndajnë si me proporcion të njëjtë vetë kumtin e kuptimeve që mbartin mesazhet e qarta në roman.

Festimi i dashurisë rrallëherë flitet aq shumë sa në 14 shkurt, ndaj dhe Baushi e nis që në paragrafin e saj të parë me këtë përshkrim të ndjeshëm: "Katërmbëdhjetë shkurti, Dita e të Dashuruarve, sot u zgjua i ftohtë, me borë, "si borërat e mia", mendova. U ngrita herët, si zakonisht, dhe, kur hapa dritaren ndjeva lagështinë e Tiranës, ftohtësinë e dimrit dhe të vetmisë. Por vetmia ime është e një lloji të veçantë, sepse është edhe shoqëruesja ime më besnike; me të bisedoj lirshëm, admiroj dhe adhuroj çdo gjë që syri më shikon, më lë në paqe me veten – e vetmja që nuk më braktis – e shpesh ndihem mirë me të." Por, ndërsa ligjërimi i dashurisë ka evoluar në baza më liberale vitet e fundit me publikun e gjerë, ajo që mund të habisë disa njerëz është se këto ide janë diskutuar prej kohësh në letërsi dhe ligjërimi daton shumë përtej Shekspirit dhe Wordsworth. Sot, entuziastët e letërsisë nuk do të jenë të huaj për veprat titullare të dashurisë që strehojnë polemika dhe mospërfillje, ndaj për këtë vetë shkrimtarja Baushi meton me penën e saj në labirinthe të reja.

Deri më sot, pyetjet e mëdha mbeten: Çfarë është dashuria? Për çfarë flasim kur flasim për dashurinë? A është një re e paprekshme që mbulon të dashuruarit, një takim pasionant, një qëndrim i guximshëm kundër të gjitha mosmarrëveshjeve, një arratisje e fshehtë, apo ka shumë mundësi - të gjitha? Diskursi i dashurisë shtrihet nëpër shekuj të letërsisë, duke mbuluar zëra dhe përfaqësime të ndryshme. Në romani e Baushit, protagonistja Drita është ajo që metohet dhe mendon se vetë e ndezi dhe e fiku zjarrin e tillë të dashurisë, ku dhe një gjethe hyn në diskurs dhe në kohë, hapësirë dhe vend me tërë forcën që i jep narrativi, ndaj thuhet qartë dhe bukur: "Dashuria për Adnanin ishte gabimi më i bukur që më ndoqi gjithë jetën. Papritur, era e jugut vërshëlleu si një tingull flauti. Ai e shkëputi dorën nga blloku e të dy instinktivisht hodhëm vështrimin përtej xhamit. Nga rrapi përballë gjethet e kuqërremta u shkëputën nga trungu dhe nisën të vallëzonin në ajër plot naze, dhe më pas u shtrinë në shtratin e butë të tokës për t'u puthur. Diku kisha lexuar "Gjethja e rënë nuk e urren erën".

Shpesh e krahasojmë shoqërinë me një pëlhurë, një jorgan që është një plejadë arnash të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, ashtu si njerëzit janë me origjinë dhe besime të ndryshme, ligjërimi i dashurisë flet për bashkimin jo vetëm të dy njerëzve, por edhe të besimeve dhe komuniteteve të ndryshme. Me fjalë të tjera, diskursi i dashurisë është i ndërlidhur. Ndaj Nexhi Baushi, nuk flet vetëm për dashurinë, por vetëm për diskursin e dashurisë, që në fakt është e pamundur të flitet aq lehtë për dashurinë pa u ndërthurur me tema të tjera si raca, gjinia, kultura, identiteti dhe ndonjëherë edhe tema si ambientalizmi, me të cilat shkrimtarja gjen formën e saj të veçantë për ta interpretuar bukur tek "Dritaret e Shpirtit".

I shkruar në një kohë thuajse dyvjeçare, që nis me muajin qershor 2020-të, ky roman shkon të huazojë kohën e karantinës, kohën më absurde të njeriut të ndaluar nga virusi, për të qenë në lirinë e tij të përditshme. Kështu e detyruar nga pandemia e stërgjatur e koronavirusit, jeta normale edhe në mjedisin shqiptar, si në të gjithë botën, ndryshoi në mënyrë drastike rrjedhën e saj, sepse të gjithë thuajse mbetën për muaj të tërë të izoluar. Në kushtet e reja që u krijuan, të gjithë pak a shumë ishin të detyruar të ndryshonin edhe mënyrën e të jetuarit e të menduarit. Për të mbajtur trupin dhe trurin në formë, Nexhi Baushi duhej që të gjitha aktivitetet t'i zhvillonte brenda banesës ku jetonte. Në kushtet e saj, duke qenë se jetoi vetëm, i mbetesh mjaftueshëm kohë për të lexuar. Nga ajo kohë e tepërt, përfitoi që të lexonte sistematikisht libra, dhe për këtë arsye iu desh të rradhiste mbi tavolinë një sërë librash të cilat i kishte blerë dhe nuk kishte patur kohë e mundësi për t'i lexuar.

Midis shumë librave që po kërkonte në biblioteken e saj, i ra në sy një libër mesatarisht i hollë, i shkrimtares italiane Suzanna Tamaro, me titull "Thuaji zemres Po". Ajo shprehet për këtë "Kisha shumë vite që e kisha blerë, por e strukur në një qoshe të bibliotekës siç duket nuk i kishte ardhur rradha për ta lexuar, herë e nxirrja dhe herë e vendosja përsëri në vendin e saj, sepse po më tërhiqnin libra të tjerë, për të cilat u bëhej reklamë e vazhdueshme si nga libraritë ashtu edhe në Panairet e Librit. E mora në dorë e rrotullova, vura re se kishte një lidhje të mirë dhe një kopertinë që i rezistonte kohës. Në pjesën e prapme të kopertinës shkurtimisht ishte shkruar biografia e shkrimtares dhe krijimet e tjera. Mendova se do të ishte një libër që do më terhiqte. Dhe kështu faqe pas faqesh deri sa e mbarova këtë libër nuk e hoqa nga dora. Një shkrim me një fuqi të madhe shprehëse, i thjeshte dhe i kuptueshëm dhe shume i dashur për t'u lexuar."

Ky libër ishte i shqipëruar me mjeshtëri nga Dritan Çela i cili prej kohësh ka zbritur hyjnërisht dhe mbërritur profesionalisht tek lexuesi shumë bukur. Ky libër që është i katëgorisë "bestsellers", i shkurtër vetëm 130 faqe trajton jetën e një gruaje, peripecitë e jetës në etapat e ndryshme dhe të fut në botën e brendëshme të saj. Ka një analizë të thelluar psikoanalistike. Të gjitha këto i janë përcjellë lexuesit aq bukur sa të mrekullon dhe se ke çfarë mëson. Natyrisht, shkrimtarja Nexhi Baushi, si një lexuese e njohur dhe mjaft e përkushtuar sqaron më tej "Kur mbarova së lexuari thashë me vete, paskam humbur një xhevahir, të vogël pa lexuar"...

PRILLI ISHTE MUAJI I NDËRGJEGJËSIMIT PËR ABUZIMIN E FËMIJËVE

Prilli ishte Muaji i Ndërgjegjësimit për Abuzimin e Fëmijëve. Gjithmonë kam ndihmuar në përhapjen e të gjithë ndërgjegjësimit për abuzimin dhe do ta bëj edhe këtë prill. Ne jemi shkrimtarë krijues, e dimë që fjalët kanë fuqi, kështu që shpresoj të shoh më shumë nga kolegët e mi shkrimtarë të përhapin ndërgjegjësimin për abuzimin këtë muaj.

Nëse më dërgoni një mesazh dhe unë do ta ndaj. Është vërtet e rëndësishme të përhapet ndërgjegjësimi për abuzimin, por këtë vit, është edhe më i rëndësishëm. Për shkak të zgjatjes së pandemisë, më shumë njerëz kanë bashkëpunuar me abuzuesit e tyre, kështu që për fat të keq abuzimi është përkeqësuar.

"Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri" (Children's Human Rights Centre of Albania – CRCA, ka përgatitut në gushtin e vitit 2005 në Tiranë, një material në lidhje me abuzimin e fëmijëve në familje, nga Prof. Asoc. Dr. Edlira Haxhiymeri, Eliona Kulluri, Altin Hazizaj i cili është redaktuar nga: Aurela Pano dhe natyrisht që është e rëndëishme të lexohet ky material. Po kështu dhe një material tjetër flet si një "Analizë e situatës së parandalimit të keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri" ku theksohet edhe "Progresi në të ardhmen". Ky raport mbi analizën e situatës së parandalimit e keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri është përgatitur me bashkëpunimin e shumë aktorëve nga ministri të ndryshme, të tilla si Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e Arsimit dhe Sportit, e Drejtësisë, e Punëve të Brendshme, si dhe organizatat joqeveritare. Studimet e kryera në Shqipëri tregojnë se shumë fëmijë vuajnë nga keqtrajtimi. Sikurse edhe në vende të tjera, keqtrajtimet më të shumta ndodhin në komunitet dhe mund të mos identifikohen nga agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve.

Megjithatë, kjo është një çështje e rëndësishme shoqërore dhe e shëndetit publik me pasoja serioze për shëndetin mendor, fizik dhe atë riprodhues të fëmijëve, si dhe për zhvillimin shoqëror. Sistemet shëndetësore kanë një rol kyç për të luajtur, jo vetëm në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për fëmijët që përjetojnë dhunë, por edhe në zbulimin dhe mbështetjen e familjeve në rrezik. Gjithashtu ato duhet të zbatojnë programe parandaluese të tilla si: vizitat në shtëpi e mbështetja prindërore, dhe ndërhyrje të bazuara në spital për të mbështetur prindërit, së bashku me programet kundër traumës abuzive të kokës. Për të trajtuar këtë problem të shëndetit publik dhe shoqëror janë të nevojshme më shumë veprime bashkëpunuese midis partnerëve. Një mënyrë për të siguruar këtë është zhvillimi i një politike kombëtare për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve.

Abuzimi i fëmijëve është kur një fëmijë dëmtohet qëllimisht nga një i rritur ose një fëmijë tjetër – mund të ndodhë gjatë një periudhe kohore, por mund të jetë gjithashtu një veprim i vetëm. Mund të jetë fizike, seksuale ose emocionale dhe mund të ndodhë personalisht ose në internet. Mund të jetë gjithashtu mungesë dashurie, kujdesi dhe vëmendjeje - kjo është neglizhencë.

Përhapja e ndërgjegjësimit i ndihmon viktimave t'u japë shpresë dhe u jep njerëzve forcë që të mos shikojnë nga ana tjetër, ta marrin atë telefon dhe ta bëjnë atë telefonatë pa pushim, nëse duhet. Ju lutemi ndihmoni duke postuar edhe mendimin tuaj mbi ndërgjegjësimin që unë do të ndihmoj të theksoj.

Hilal Food Centre
HALAL MEAT
PREMIUM QUALITY
FRESHLY PACKED TO ORDER
ÇMIM KONKURUES
ARYA FOOD CENTRE
GËZUAR MUAJIN E MADHËRUESHËM TË RAMAZANIT
Adresa:
159-160
PARROCK STREET
GRAVESEND
DA12 1ER

RREGULLI ËSHTË I THJESHTË, NËSE NUK E DUAM, NUK E SHESIM

Supermarketi "Arya Food Centre" u angazhua për të ofruar shërbimet e tij për konsumatorin shqiptar në zonë e Gravesend ku ai operon, falë ideve dhe angazhimit të pronarit të tij Salman Şiringül. Ky supermarket afron të gjithë shërbimin e tij më të mirë, duke u dhënë kështu shqiptarëve të asaj zone dhe zonës përrteh mundësi për të gjetur cilësi, kualitet dhe konkurrim çmimesh.

Salman Şiringül ishte në vijën e parë edhe në kohën e Ramazanit, duke shërbyer me ulje çmimesh. Mallrat ushqimore janë të një cilësie të lartë. "Arya Food Centre" vazhdimisht teston shijet e përzgjedhjes në rritje të produkteve fantastike shqiptare në gamën e ushqimeve dhe pijeve shqiptare dhe sikurse mësohet nga pornari Salman Şiringül kur ai shprehet se "jemi shumë të veçantë në lidhje me markat që kemi në "Arya Food Centre". Rregulli është i thjeshtë, nëse nuk e duam, nuk e shesim.

Nga markat më të njohura turke deri te prodhuesit e vegjël artizanal të ushqimeve më të mira turke, të gjitha bazat janë të mbuluara, duke përfshirë bukën turke (ne jemi i vetmi dyqan online me pide turke të freskët të pjekur çdo ditë. Po, po mburremi. Ju mund t'i bleni dhe gjeni sendet tuaja ushqimore turke dhe shqiptare të gjitha menjëherë. Djathëra të shijshëm dhe të pjekur Ezine dhe Kaşar, mish me erëza turke si Pastırma (pasturmah), Sucuk me lëng (soujouk), bishtajore dhe kokrra të shëndetshme nga Kosov, Shqipëria dhe Turqia, turshi shqiptare dhe turke, ushqime turke, erëza dhe barishte turke, ullinj dhe vajra turq, salca , reçelna dhe pasta dhe më shumë.

Salman Şiringül shprehet se "Ne po monitorojmë vazhdimisht cilësinë e të gjitha produkteve në gamën tonë të dërgesave ushqimore turke. Me çdo marrje, ne riprovojmë markat tona të preferuara për t'u siguruar që të merrni produktet më të mira turke të dorëzuara në derën tuaj."

Për shqiptarët janë të gjitha produktet e salcave, ajvarët me djegës dhe të ëmbël, ata të mesëm e të gjithë llojet e sallamrave. Ka djathra të ndryshëm nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, Qipro etj.

Mishi është mjaft i freskët, sikurse ka mish hallall dhe fruta e perime të mara direkt nga fusha dhe nga tregu i veçantë. Ky është tashmë një supermarket që konkuron në atë zonë dhe prandaj u afron të gjithë shqiptarëve mundësinë për të qenë më të lidhur me të.

FILOZOFIA METAFIZIKE E LUNDRIMIT NË VARGUN POETIK TË MATOS

Në këtë analizë të librit më të ri poetik të poetit Agim Mato duam të ndalemi në lidhjen metaforike që qaset mes artit të fjalës për të ripërcaktuar dimensionin logjik dhe artorganik të fjalës që lëvrohet nga ndikimi i një hapësire kulturore. Tek vëllimi poetik "Lundrimi" (2014) me redaktor një emër të njohur në letrat bashkëkohore shqipe, Pandeli Koçi (alias Sazan Goliku) dhe në botimin e "Milosao"-s, poeti Agim Mato na jep një qashtërsi (më shumë se qartësi poetike) prognozën filozofike të lidhjes dhe arsyes me detin, mes një metafore që lind, rritet dhe zhvillohet e pavdekshme tek procesi më determinues i lidhjes së njeriut me detin, lundrimin (brenda shpirtit si nocion). Lundrimi është vetë roli që arsyeton, por që edhe na jep mundësinë të kuptojmë më thellë. Për këtë studimi do të ndalet tek roli i detit në kulturën njerëzore, aspektualiteti i tij Jonik në krijimin ndikues të rrethnajës, ndikimi i lundrimit si filozofi në vargun e poetit dhe më tej me një zbërthim të tërë dimensionit që jep vëllimi, si qasja kulmore në krijimtarinë poetike të viteve që pasojnë një vrull poetik të vargut të bardhë. Mes kësaj ndalesat do të jenë për të dhënë arsyen, pse Mato mbetet një poet tipologjik me vlera në krijimtarinë e tij.

Deti, rrethnaja e dyfishtë kulturore tej lundrimit nga vetja

Roli i detit në kulturën njerëzore ka qenë i rëndësishëm për shekuj, ndaj dhe si i tillë edhe për poetin Mato, ai vazhdon të jetë më shumë se arsyeja e arsyeve. Deti është vetë procesi, zhvillimi, heshtja, gëzimi, trishtimi dhe vetë komunikimi. Si poet dhe si njeri ai e përjeton detin në mënyra të ndryshme, herë të qeta dhe pajtuese, por jo pak herë edhe kontradiktore. Deti në vargun e tij është jo thjesht det, por një aspekt ku zanafill 'lundrimi' poetik. Ai është aq i fortë, por i qetë, i bukur, por i rrezikshëm. Përgjigjet e poetit Mato në det mund të gjenden në artformësimin e përfshirë të letërsisë poetike të tij, në ndjenjën dhe shijen e artit piktoresk, poezinë e krijuar në vite, filmimin mes memorjes dhe kapjeve të aparatit, teatrin e tij jetik dhe njerëzor të luajtur mes heshtjes dhe përndjekjes në vite, dhe muzikalitetit klasik të valëve dhe dallgëve. Një art i tillë ka ardhur në leximin e poetit mes njohurive dhe shijeve të tij, ndoshta me atë që hershmëria e përfaqëson që 40.000 vjet të shkuara. Që atëherë, artistë në vende dhe kultura të ndryshme kanë përshkruar detin, ndoshta në një kah të ndjeshëm me shpirtin e tyre artist. Simbolikisht, deti është perceptuar si një mjedis armiqësor i populluar nga krijesa fantastike: Leviathani i Biblës, Isonade në mitologjinë japoneze, 'dhekraken' e fundmitologjisë skandinave. Në veprat e filozofit Karl Jung, deti simbolizon personalen dhe pandjenjën kolektive në interpretimin e ëndrrës. Profesori Eqerem Çabejqë herët në studimin e tij monografik "Për gjenezën e literaturës shqipe" (1939: 61-65). Thekson se 'një aksiomatikë e dyfishtë' ka ekzistuar mes këtyre lidhjeve dhe literaturave. Si pasojë deti dhe lundrimet janë përshkruar në art duke filluar nga vizatime të thjeshta në muret e kasolleve në Lamu nga i mirrënjohuri Joseph Turner. Artisti Japonez Katsushika Hokusaika krijuar punime me ngjyra të disponimit të detit. Deti është shfaqur në letërsi që nga "Odisea" e Homerit (shekulli i 8-të pes). Deti është një

temë e përsëritur në poezinë haiku e japoneze të lëvruar nga poeti Matsuo Basho (1644-1694) . Në letërsinë moderne evropiane, romanet e detit dhe të frymëzuara si të tilla janë shkruar nga Joseph Conrad, Herman Wouk, dhe Herman Melville. Deti ka frymëzuar shumë muzikën gjatë shekujve. Varrimi në det ka qenë praktikuar në mënyra të ndryshme nga vende të botës që nga qytetërimet e lashta të Egjiptit, Greqisë dhe Romës. Kështu lundrimi në det ka qenë dhe mbetet formëzimi i gjithë prezencës jetike dhe të përtejme, madje edhe një arsye për të rikrijuar komunikim me rrethnajën. Kështu mbetet tek poeti Mato edhe mes vëllimit, por që nis edhe tek poezia "Deti": "Ishe altari ku rrëfehesha. Flisja e flisja mes mërmërimës/së dallgëve/me një zë që të mos kuptohej nga të tjerët./Kur ngriheshin tallazet e tua,/e ngrija edhe unë zërin/dhe bërtisja mbi shkëmbinj nga frika se s' më dëgjoje." (Mato, 2014: 5). Shihet qartë mes kësaj poezie ajo që në fjalën e Çabej vjen si një 'niveau' (nivel) kulturor, ku qasen reagimet njerëzore (ibid).

Reagimet e njeriut në det janë gjetur në letërsi, art, poezi, film, teatër, dhe muzikë klasike, si dhe në mitologji dhe interpretimin e ëndrrave psikoterapeutike. Rëndësia e detit të kombeve detare është treguar nga ndërhyrja që ai bën në kulturën e tyre; përfshirja e saj në mit dhe legjendë. Përmendja e tij në fjalë të urta dhe këngë popullore; përdorimi i lundrimeve në ofertat kushtimore; rëndësinë e lundrimeve dhe deti si nocion në ceremonitë e pranimit dhe në ritet mortore; fëmijët duke luajtur me anije lodër; të rriturit me anijet e mëdha; turmat e mbledhura në nisjen e një anijeje të re; njerëz duke medituar në mbërritjen ose largimin e një anijeje dhe qëndrimin e përgjithshëm ndaj çështjeve detare. Këto e mjaft gjëra të tjera që lidhnin Sarandën dhe lidhin tashmë më gjerë në hapësirën e saj ujore me fqinjin kulturor, si në Jug dhe më gjerë, i japin vargut dhe njëkohësisht, poetit dhe piktorit, artistit dhe vizualpikturuesit Mato, arsyen pse vargu i tij thith dhe jep ajër mes lundrimit detar. Simbolikisht, deti ka qenë prej kohësh dhe konsiderohet ende si një mjedis armiqësor dhe i rrezikshëm, pasi është i populluar nga krijesa fantastike: Leviathan gjigant i Biblës, Scylla në mitologji greke, Isonade peshkaqeni në mitologjinë japoneze, anijet e gëlltitjes në mitologjinë skandinave. Por edhe në veprat e filozofit Karl Jung, deti simbolizon personalen dhe atë pa ndjenja kolektive në interpretimin e ëndrrës. Ndaj edhe vargu jungian i Matos, e... *(vijon në faqen 18)*

(vijon nga faqja 17)

...gjen dhe pështjell ëndrrën e tij të ndaluar nga 'kartonizimi' mes detit, lundrimit dhe valëve e dallgëve të tij: "Më mbuloje atëherë me shkumë/ dhe lëpija kripën tënde/ së bashku me lotët." (ibid). Jug dhe më gjerë, i japin vargut dhe njëkohësisht, poetit dhe piktorit, artistit dhe vizualpikturuesit Mato, arsyen pse vargu i tij thith dhe jep ajër mes lundrimit detar. Simbolikisht, deti ka qenë prej kohësh dhe konsiderohet ende si një mjedis armiqësor dhe i rrezikshëm, pasi është i populluar nga krijesa fantastike: Leviathan gjigant i Biblës, Scylla në mitologji greke, Isonade peshkaqeni në mitologjinë japoneze, anijet e gëlltitjes në mitologjinë skandinave. Por edhe në veprat e filozofit Karl Jung, deti simbolizon personalen dhe atë pa ndjenja kolektive në interpretimin e ëndrrës. Ndaj edhe vargu jungian i Matos, e gjen dhe pështjell ëndrrën e tij të ndaluar nga 'kartonizimi' mes detit, lundrimit dhe valëve e dallgëve të tij: "Më mbuloje atëherë me shkumë/dhe lëpija kripën tënde/së bashku me lotët." (ibid).

Siç shihet vlera e detit, mes vargut të Matos, merr një dimension tjetër. Ndoshta ajo që bashkon dhe ribashkon filozofikisht kulturat. Në Azinë Juglindore, rëndësia e detit rritej mes vlerave epike, princeshat në ishuj të largët, monstrat dhe peshqit magjik tek përgjojnë në humnerë futen edhe mes vargjeve të poetëve. Janë jashtë izolimeve, por edhe brenda dyzimeve. Kjo e qartë tek vargjet e poetit ku "Oqeanikët me dritat shumëkatëshe kalonin përballë/dhe nuk e ceknin tokën time, pëlhurat e velierave/atje larg i shtynte një erë tjetër/që mushkritë e mia s'e kishin provuar." Dhe ku poeti vjen dhe qëndron mes detit si "...një Robinson Kryzo i vogël,/derisa gjiri u skuq nga balta që tretej/dhe pemët u shembën mbi ujëra, si udhëtimeve që nuk/i bëra." (ibid). Autori lexonte literaturën e ndaluar, që ia kishte lënë mënjanë fshehurazi babai i tij vizionar, Remzi Mato, artist në novacionet e tij, i papajtuar me stuhinë e dallgëve të sistemit, dhe kuptonte se 'mbretërit' e hapësirës detare ishin vargjet, artit i fjalës, që ashtu si shumë kombe që besonin se Poseidoni ishte zot i detit, edhe vetë ky varg i bardhë, i lirë ishte pikëtakuesi me mitin. Këtu ai padashje i jepte jetë në zhvillim vetë artit jonian, atij arti që merrte volumin e frymëmarrjes nga 'influenca e thellë' ku 'distanca midis poetit dhe popullit' nuk ishte shumë e madhe (Çabej, 1939: 61-65). Kjo distancë bëhej akoma më e ndjeshme në lidhjen artorganike me detin: "Pranë meje notonin peshq të ngathët/e të verbër të thellësive,/të pamësuar me dritën,/të rënë sa herë në rrjeta dhe të gjuajtur/me shkelma nga peshkatarët, sërish në ujë./Isha si i verbuar edhe unë nga një pluhur i dëndur/drite./Tërë fjalosjet vetmitare,/tërë rrëfimet e pafundme me ty/filluan të më rrethonin/si një brerore e padukshme shpresash/ që ngjitej nga thellësia e labirinteve nënujore./Ndjeja të më merreshin mendtë/ dhe mesdita më flakte pranë teje,/dhe gjumi më zinte përzier me rërën e nxehtë,/ me algat përsipër/dhe valët që më rrihnin në brinjë./ Shaluar mbi një kalë deti bridhja në thellsirat e/ëndërrta të koraleve/dhe ndjeja të më firasej trishtimi,/të më avitej Poezia,/si rrezet e dritës/ që kullosnin mbi hapësirën tënde, o det./Frikë nuk pata më se mos më dëgjonin të tjerët." (ibid). Kështu frika se mos e dëgjonin të tjerët, e bënte poetin të strukej në këtë det, mes lundrimit të tij të heshtur, pasi ai kishte format e tij të hershme të datuara e të tipologjizuara në mjedisorganikën e tij kulturore, ku vetë lidhja jonike transmetonte në heshtjen e saj. ky det i shfaqur në literaturë, të paktën që nga koha e Homerit, i cili e përshkruan atë si "e verës së detit të errët" (oînops PONTOS), tashmë qasej deri në strukun e majëfjalës së zhytur në thellësinë e mendimit të poetit Mato. Ndërsa tek "Odiseja" gjente pikërrëfimin e udhëtimin e heroit Odise që lufton për tu kthyer në shtëpi nga përtej detit pas luftës me Trojanët, e përshkruar në Iliada, ai, pra poeti shqiptar, Mato gjente arsyen të rikthente në vetvete fjalën e artë që përballej me Trojën e kartonizimeve, me ndalimin e tij lundrues e të qetë mes botimit poetik. Fluturimin e tij të përçart e merr nga një vend në një tjetër, duke përjetuar ndër rreziqe të tjera detare, ku shfaqet deti i ri përbindësh, jo si atëherë Scylla, vorbulla Karridba dhe ishulli Ogygia i nimfës Calypso, por tërë nomenklatura tjetër që lagej në det dhe jetonte tej detit dhe hallve të tij, ajo që shfaqej e frikshme në arsyen e joarsyen e fjalës. Ndaj dhe vetë poeti citon se "Lundrimet e mëdha fillojnë nga shpirti". Në ndihmë na vjen edhe Çabej me dy aksiomat e tij, ku thekson e para është influenca e rrethnajës krijuese dhe e dyta është ngjyra politike e shkrimtarisë, me qenë se fatet e posacme socialpolitike kanë shtruar një influencë të shënuar në të lindurit e literaturave' (ibid). Poeti, sipas Çabej, është 'një prijës shpirtëror' që i ka 'rënë këtu zakonisht dhe barra e apostullit nacional' ku gjithnjë duhet ta vendosë penën në shërbim të identitetit të tij, kulturës së tij, arsyes dhe mendimit në të mirë të fateve njerëzore dhe të vendlindjes (ibid). Kjo lidhje me vargun e Matos është më shumë se lundrim, është një falenderim ekzistence, për njeriun e tij të dashur, më të afërtin e jetës, atij që i dhuron edhe ekzistencën: "Kur erdhe ti/u terratisën perënditë e rreme/ që vërtiten rrotull njeriut./ Deri në ato çaste nuk e dija që ekzistoje." (ibid). Është kjo ekzistencë pikërisht në lundrimin e poetit ku jeta, toka, hapësira dhe deti marrin forma të reja: "Drita që solle papritur ma trembi vetminë/ dhe, i pamësuar me të, nuk guxova/të rri gjatë përballë teje,/që të mos vuaja. Pyesja hijen time/prej Heminguei dhe ajo bëhej më memece se unë.". Është kjo ekzistencë që mes lundrimit mbeti një besnike e përbetuar e artit të fjalës, që në jo pak raste mundej dhe mundohej nga heshtja e dallgëve që shkisnin vetëtimthi.

Aspektualiteti Jonik dhe rrethnaja si tipologji midis formës dhe strukturës

Në përgjithësi vargu i poetit Agim Mato, i qasur mes dallgëve të shpirtit dhe atyre të rrëthnajës, apo edhe vetë detit Jon, i japin qasje të lirë aspektualitetit Jonik, ku rrethnaja determinohet dhe agravon deri në detajin më të ndjeshëm. Rrethnaja si e tillë krateret në hapësirën që krijohet si tipologji midis formës dhe strukturës. Herë pas here 'stanzat' variojnë dhe vargu i Matos kapërcen numeracionin dhe enumeracionin logjik, ku secili përmban një numër të ndryshueshëm të vargjeve. Pjesë lojëparësore poetikeshihet në strukturimin e tij, përthyerjen sipas logjikës poetike, ndalesën e reduktuar, ndryshesën në arsye dhe kapërcimin foljor. Tek mjaft poezi të tij shihen katërmbëdhjetë rreshta, i dyti, i treti dhe i katërti kapin numeracione të ndryshme që variojnë. Sa për skemën në vargje, nuk ka skemë të dukshme rimëbrendore, ose logjike, që synon një vend trajtimi të lirë të modelit bazë jambik që zakonisht ushtrohet pak herë nga autori, por që veçon në strukturën e tij. Në mjaft poezi ka një seri të zanoreve të hapura (melankolike, të gjatëvëna, tërheqjen në arsyetim për të na dhënë një minigjëmim të brendshëm brenda zanores, si në përshpirtjen e saj zanore kur lidhet me arsyen e fjalës)...

“BIG BOSS SERVICES UK LTD” ME KUOTA NË RRITJE

Kompania shqiptare “Big Boss Services UK Ltd” që drejtohet nga biznesmeni Gazmend Cufaj ka kohë që po bën emër të ndjeshëm e të respektuar në mesin e bizneseve, klientëve dhe të kontaktuarve të shumtë të saj. Ajo dallohet dhe gjithnjë ka marë konsiderueshëm vlerësime të ndryshme. Për këtë mbetet dhe prioriteti i saj i vazhdueshëm që të risë të gjitha kuotat e shërbimit cilësor, duke i dhën prioritet kërkesave në rritje të kohës dhe të klientëve të saj.

Ndërsa nga data 3-5 maj 2022 në Londër zhvillohej ngjarja më e madhe e mjedisit të ndërtimit në Mbretërinë e Bashkuar, me kompani fituese me shumë çmime, e sivjetmja tregoi se po vjen në kryeqytetin e Mbretërisë së Bashkuar për t’i treguar botës se çfarë po ndodh në industrinë e ndërtimit. Aty të gjithë kishin mundësinë për të përjetuar 1000 produkte inovative, 100 ekspozues ndërkombëtarë dhe një seri seminaresh aktuale dhe tërheqëse me folës kryesorë në industri. Aty kishte dhe shumë karakteristika fantastike duke përfshirë Zonën e Inovacionit, një vitrinë shpikjesh që do të ndryshojnë industrinë e ndërtimit.

Një ftesë speciale ishte dhe për biznemsenin shqiptar, Gazmend Cufaj, drejtues i suksesshëm i “Big Boss Services UK Ltd”. Ai vetëm pak ditë më parë festoi ditëlindjen e tij dhe kështu pati një arsye më shum ëtë ishte sërrish festiv dhe në planet e reja që tashmë shtohen dhe kryqëzohen me atë që duhet të mbetet prioritet në vazhdim. Ndër punërat mjaft të suksesshme të këtij biznesmeni tashmë të falenderuara nga insitucione të ndryshme, natyrisht janë dhe ato që i përkasin

komuniteteve të ndryshme në MB.

Prandaj dhe Java e Ndërtimit në Mbretërinë e Bashkuar në Birmingham ishte dhe ajo në kohën e duhur për të krijuar më shumë ide dhe për këtë kompani që drejtohet nga zoti Cufaj, por dhe për të lidhur industrinë e ndërtimit, një katalizator vendimtar për rimëkëmbjen ekonomike të MB. Java e Ndërtimit në Mbretërinë e Bashkuar normalisht ishte dhe një shtysë tjetër për projekte të tjera të “Big Boss Services UK Ltd”. Pra sikurse shihet gjithnjë “Big Boss Services UK Ltd” mbetet me kuota në rritje.

NUK ËSHTË THJESHT E THJESHTË

E hodhi pallton e madhe krahëve dhe ngau kalin e tij dorí në rëzë të Malit. Me vete kishte një thes me ëndrra dhe një dolli të pangritur për mikun e tij të ri që i ishte ulur në sofër pas një viti mëri për atë dolli të pangritur në ditëlindjen e të Madhit.

Në xhepin e brendshëm të palltos kishte tre fara të ndryshme, që do të sillnin në jetë pemën e ëndërruar. I kishte ndarë me kujdes në tre peceta. Farat ishin të lidhura me ëndrrën, po aq dhe me dollinë e pangritur në ditëlindjen e të Madhit.

I hodhi të trija dhe ashtu në rrëzë të malit priti të ngrihej në këmbë pema e ëndërruar, që i la dollinë në mes e që ëndrra i kishte premtuar, se do ti sillte përgjithmonë, pasuri, dituri e lumturi. Ajo pemë, që sa hapi e mbylli sytë, e pa vetë ai, aty në atë rrëzë të freskët e të paqme të Malit. E pa dhe nuk u besoi syve. Dhe u kujtua për dollinë. Dollinë e pangritur në ditëlindjen e të Madhit. E pastaj…, pastaj menjëherë vendosi ta thërrasë mikun e tij të ri. Nuk kishte tashmë me të, më mëri. Kështu që duhej ngritur ajo dolli.

1.

E ndërsa priste mikun, pas gjithë atyre jehonave që ndau e përcolli jehona e grykës ai vazhdoi me ëndërrat e tjera... Pema rritej dhe nxirrte frutat e para.

Një degë e pemës nxorri frutin e lakmisë. Kështu që gjithçka që duhej që pema të ushqehej ishte të ushqehej me nevojat e tij. Por ai nuk ndejti duarkryq. E pastroi pemën nga të gjitha barërat e këqija, dhe pastaj vendosi të gërmojë thellë për të parë se çfarë fshihej tek kjo pemë.

Atje ishte, e gjithë ndotja e tij e jashtënxjerrshme trupore, ashtu së bashku, në front të qepallave të tij.

Rrënjët e kësaj peme ishin zhytur thellë në të dhe kishin filluar të rriten e të zgjaten në të gjitha drejtimet. Zgjatime pafundësisht të pangopshme. Tashmë ajo pemë nxirrte mbi dhe frutin e lakmisë dhe nën dhe mbante farën e pangopësisë.

2.

Si mund të ndodh kjo? Një farë na doli për lakminë, një farë tjetër për pangopësinë ..? Po e treta? Ai për këtë vuri në lëvizje të madhe syrin. U përpoq të shikojë përmes misterit të farës së fundit që mbodhi të gjithë lëvizjet e dheshme e të nëndheshme për të gatuar vaktin e fundit të madh. Duke vëzhguar e ndjekur me kujdes e ndjeu se e treta po vonohej... Atëherë vuri në punë trurin e tij. E donte me të gjithë arsyen të dinte kuptimin e së vërtetës. Donte të dinte se çfarë duhej të bënte më tej me ëndërrat e tij.

E që të vinte në lëvizje ëndrrat ra në gjumë aty nën hijen e saj peme. Ëndrrat, si ëndrra i dolën menjëherë dhe të gjitha i ngatërroheshin me dy frutat e kësaj peme, që i nxorri nxitimthi: lakmia dhe pangopësia.

Për një moment u trondit. Kishte frikë se kishte mbjellë bashkë me tre farat edhe ëndrrat e tjera. Kishte frikë. Po sikur t'i kishte humbur? Si do t'i tregonte mikut të tij të ri? Po pastaj a duhej më ajo dolli për ato tre fara?

E dinte që i detyrohej shpirtit të kësaj peme, për njohurinë që i jepte dhe ndaj vazhdonte të besonte ...

U përpoq të risillte ëndërrat duke i rithirrur pas gjumi në kujtimet e tij, por si gjethet e pemës ata filluan të bien e të bien ... përfundimisht ...

3.

E gjitha rikthehej në pleh. Pleh. Pleh. Pleh...

Dhe fap u ngrit. Pranë tij ishte kali dorí, torbat e tij, dhe miku që po trokiste atë dolli.

Zgjohu! Zgjohu, ore mik, zgjohu tani.

Këtu paska mbirë një pemë. E sheh, e ke në sy!

Po, po e shoh... e shoh ka disa ditë, që më ka errsuar edhe sytë.

Ajo po më vret mua çdo ditë, duke jetuar, duke e njohur atë, jo për mua .. jo më thjesht për mua ...

4.

E hodhi pallton e madhe krahëve dhe ngau kalin e tij dorí prapa rëzës së Malit. Me vete nuk kishte më një thes me ëndrra, as edhe atë dolli të pangritur me mikun e ri, që i ishte ulur në sofër pas një viti mërije për atë dolli të pangritur. Kishte tashmë lakminë dhe pangopësinë, me të tretën të strukur në sy ku mbahte ngrohtë brendësinë.

Ikte fluturimthi me kalin e tij dorí dhe pyeste veten: sa kohë do më duhet të mbjell e të rimbjell lakminë dhe pangopësinë që të zbukuroj brendësinë?



FILLIMET E LETËRSISË FILOZOFIKE SHQIPTARE

Kumtesë, rreth librit "Paritet" të Prof. Dr. Fatmir Terziut)

Pa e shfletuar librin "Paritet", krijojmë përshtypjen se nuk kemi të bëjmë me një prozë të zakonshme, që jemi mësuar të lexojmë. Në kopertinën e këtij libri, shënohet shprehja "filozofi", në vend të fjalëve të mirënjohura, poezi, tregim etj... Me kaq informacion sa kam, nuk kam parë ndonjë liber tjetër me këtë shënim në kopertinë. E kam fjalën, për librin, në gjuhën shqipe. Kemi të bëjmë me një libër filozofik të mirëfilltë, që nga A-ja, deri te Zh-ja. Seicili libër, edhe ai poetik, shtjellon një lloj filozofie, që i përket temës, rreth të cilës vërtitet, por nuk na i jep të çveshur subjektin filozofik, të cilit i përket. Ne, si lexues vetëm e nënkuptojmë, këtë synim të autorit, por shpesh jo të gjithë lexuesit zbulojnë të njëjtën filozofi, në të njëjtin libër, që lexojnë. Ky dyshim, edhe një herë të vetme të ndodhi, përbën një problem madhor, sepse boshti filozofik e dallon autorin. Ai po nuk ishte i qartë vetë, si do të na qartësojë ne, pra lexuesve. Është kjo arsyeja, që në botë, u krijua një zhanër, krejt i veçantë i letrësisë, që u mbajt me emrin, të cilin e sipërtregova. Filozofët e shëkullit të nëntëmbëdhjetë shkruan shumë libra, me doktrinat e tyre, që ishin nevojë të sqaroheshin, përpos përcaktimeve filozofike, që u ngjajnë teoremave algjebrike. Fjalët "libër filozofik", ishin shkruar vetëm në gurë dhe mbetën kështu për shtatëmbëdhjetë shekuj. Kjo fjalë në libër u shkrua vetëm kur u afirmuan filozofët e kohës moderne, që lidhën dy epokat e mëdha të njerëzimit. Në gjuhën shqipe, këtë privilegj e pati libri "Paritet", të cilin e kemi në analizën tonë.

Filozofët e rinj, që nga Shopenhauer, deri tek Niçe (Nietzsche), krijuan lidhjen midis filozofisë së antikitetit me filozofinë e re. Veprat e tyre u shkruan në stilin e prozës, duke theksuar se jeta është filozofi. Për këtë e ripërsëris, kemi librin, që analizojmë në këtë kumtesë modeste.

Mendoj se vepra e Sami Frashërit, "Shqiperia ç'ka qenë dhe ç'do të bëhet" është prozë me sens filozofik. Nga titulli, mendoj se edhe romani, "Pse" i shkrimtarit tonë, Sterjo Spasse, duhet të ketë sensi filozofik. Meqenëse nuk e kam lexuar këtë roman, nuk mund të them me siguri se është, ose jo me këtë drejtim. Veprat e shkrimtarëve të mëdhenj, Hygo, Tolstoj, kanë luajtur rol filozofik, pa u emërtuar si vepra e tyre "filozofike". Me këtë dua të them, se përpara se ata të jenë gjeni, janë filozofë.

Libri "Paritet" i Fatmir Terziut, është filozofik i vërtetë, i ngjashëm me prozën e filozofëve europianë, të cilët i lart përmendëm. Ngjarjet autori i vendos në mjediset e zakonshme të jetës së përditshme shqiptare, duke na sqaruar edhe kuptimin filozofik të ngjarjeve, të ndodhura në historinë. Evendit tonë dhe në mjediset ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët, madje dhe kur janë në kushtet e jetës në vende të tjera, si emigrantë. Në të tëra këto mjedise autori e gjen të zbatuar filozofinë njerëzore shqiptare, jo të izoluar, por si pjesë e filozofisë botërore, për shpjegimet e fenomeneve dhe të teorizimit të tyre.

Duke qenë se filozofia ndodhet në jetën e përditëshme, ajo mbetet edhe një kordinim, midis fenomeneve të natyrës dhe të ngjarjeve historike. Vetë filozofia nuk është shkencë,



por mbështetet në arritjet shkencore, për të shpjeguar përmbajtjen dhe lidhshmërinë, midis shkencave. Paturpësisht në monizëm, marksizmi, quhej shkenca e shkencave. Nuk besoj se ekziston një absurditet tjetër, si ky i monizmit.

Të shkruash një libër kaq kompleks, me përmbajtje fund e krye filozofike, nuk është një nismë e zakonshme. Nuk kërkon vetëm aftësi shkrimore, por duhet dhe një kulturë solide filozofike.

Filozofët europianë me emër, janë ndodhur përballë kritikave të ashpra, të kolegëve të tyre, dhe popullarizimi i tezave të një filozofi, nuk e ka pasur të lehtë të njihet nga bashksia e botuesve, që kishin të drejtën e publikimit. Se sa e ashpër dhe rigoroze ishte kjo rrugë, mjafton të përmendim fundin tragjik të disa filozofëve, që kulmoi me vetëvrasjen e Niçes së madh. Do të thoni pse e quaj të madh? E quaj të tillë, sepse edhe sot, shumë teza të tij, nuk janë zbërthyer nga kompetentët e fushës së filozofisë.

1.Trajtesa

Të kthehemi tek problemi ynë. Libri filozofik kërkon njohuri historike dhe filozofike universale. Autori ynë, ka paraqytur mbi 150 sythe, në formë të nëntitujve. Kjo mënyrë kompozimi e librit filozofik, i përshtatet nivelit të ndryshëm të lexuesit shqiptar. Por në një plam më kryesor, lexuesi presupozohet të ketë arsimin e kompletuar dhe të jetë i paisur me instiktin e rremuesit të bibliotekave. Libri filozofik nuk të nanuris.

Në kumtesën time, nuk do të komentoj të tëra esetë, me të cilat argumentohet sythi, për anën letrare. Jam përqëndruar në ato pjesë të esesë, që argumenton sythin, në drejtim filozofik. Me këtë mënyrë do të u jap mundësi lexuesve të orientohen, për përmbjatjen filozofike të librit dhe shpresoj që të u nxitet dëshira për ta lexuar këtë vepër, që do të i ndihmoj ata jo vetëm në kulturën filozofike, por do të orientoj dhe lexuesin, do të jetë edhe për çdo shkrimtar, i çfarëdo drejtimi qoftë...

MAMA TË BËRA PREJ NËNE

Nga Faruk Myrtaj

"Aty e ke mamin?!"

Ai që pyet është im bir.

"Mami", nëna e tij, është edhe ime shoqe. Po aq e qartë: "mami I tij" nuk është 'nëna ime'.

Ngaqë nëna ime, prurësja ime në këtë jetë, s'është më, këngëzimin "mami" të tim biri unë e dëgjoj si "prej lënde të nënës sime".

Në çastin tjetër, nis dhe tëholl për ta pranuar ca më tej ndjesinë se edhe ime-shoqe është bërë prej lënde të nënës së saj. Një ndjesi jo aq e kollajtë kjo për tu rrokur prej tim biri, edhe sikur unë të përpiqesha t'ia kthjelloj fjalësh. Duhet edhe ngè, edhe kohë e gjatë, për ta bërë këtë. Së paku aq sa mu desh mua për të ndjerë fjalën "mama" gjersa kur mw duhet ta kujtoj thjesht si Nënë…

'Si gjithë fëmijët e botës në moshën e tij!', e justifikoj tim bir, duke iu gëzuar diferencave në moshë dhe në kohë me të.

"Po, këtu është, në ballkon…", i them. Për mamin e tij.

Biri e di, ballkoni prej kohësh shërben truall bisedash mes ne të dyve kur jemi në të mira, dhe si arenë meditimi vetjak a heshtje përbashkët sa mundim të gjatë, kur kujtohemi se sido si jemi dy qenie të ndryshme, natyrshëm të mëvetëshme, në kohë pambarimisht të mëtejshme.

Sado të duhemi, sado të mirë-kuptohemi, do na duhet, për fat do na duhet, e themi këtë si me gëzim, mrekullisht pashmangshëm, si shenjë mëvetësie dhe lirie pra, do të mbetemi dy. Dy në një, por gjithnjë dy. Duke e gëzuar pambarimisht edhe këtë, si lajm të bukur. Edhe tani, madje sidomos tani, që po arrijmë aty kur mund t'i gëzohemi faktit që po moshohemi së bashku…

Edhe këto ditë, kur temperaturat kanë zbritur në një duzinë gradë Celsius, ballkoni është frymëmarrje plus prej hapësirës së brenda-shtëpisë.

Kishte kohë, sidomos ime-shoqe e qetësonte veten pikërisht aty. Ku mund të ndizej edhe ndonjë cigare, do shtoja më vonë si kujtesë. Provoja hera-herës të ndjehesha unë vet shkaku i kësaj gjendjeje, nëse mund të quhej "gjendje", në nuancë agravuese, gërvishtëse, ndonëse ajo ngulë këmbë se lejimi i vetes në hapësira të tilla meditimi do t'i bënte mirë kujtdo. Jam gati ta pranoj të plotë fajësinë time, për të vogëluar ose tretur të tërin trishtim të saj por, që t'i dorëzohem meditimit, në po këtë mënyrë si ajo, me mbyllje sysh, aq më pak me përqëndrim mendimi në një subjekt të zgjedhur, e gjej të pamundur. Jo pse kam ndrojtjen se, për të kërkuar symbyllur lehtësimin do mund t'ia blatoja fajin asaj, shoqes sime të jetës, jo, kurrë.

Në të vërtetë po më bëhej gjithnjë e më shumë se ime shoqe po bëhej e tjetërt tashmë. Edhe pse s'ishte kollaj të thosha dot në ishte më i mirë apo më i brishtë shëndeti i saj, më e shtuar e qeshura e saj që lutja të shfaqej përpara syve të mi. Mbase edhe vet termi 'shëndet', kuptimi i tij, do duhej konceptuar ndryshe këndej ku e sollëm veten, sic i tërë gjërave që kishim lënë pas në të vërtet, për të arritur te kuptimet e tjera, që gjetëm apo që do të na ndodhnin kësaj an'bote ende në mos-njohje.

"A ma jep pak në telefon, ba..?! Ndaj telefonova!"

"E po mirë, nëse të duhet të flasësh me se s'bën, po provoj!"

Me pulpat e gishtave të dorës, trokita në xhamin e derës që hapej për në ballkon. Si s'mora shenjë që isha dëgjuar prej Saj, bëra ta hapja lehtë-lehtë kanatën e qelqtë, me kujdesjen e duhur të mos shtonte as edhe një fije nervozizëm në qetësinë e meditimit atje.

"Më lerë, të lutem, si s'më kuptuat një herë...Në këto momente s'jam këtu, jam diku tjetër, s'jam për askënd..."

S'do doja t'i dëgjoja sërish, por ishin të pashmangshme, si gërvërima e pafajshme e derës që duhej hapur. Eh, sa shumë gjëra s'do donim të na ndodhin, në këtë gjeratore që na sjellë vërdallë e na përthithë, edhe pse vazhdojmë ta quajmë jetë dhe duam ta zgjasim pafund.

'As për tët bir…nuk je?!' do pëlqeja të thosha, me sado pak ndjesi shakaje brenda, por dora e saj u ngritë si krah i lodhur shpendi, në përtim të thellë, elegant, pa kthyer kryet, pa nxjerr asnjë fjalë tjetër, por edhe kësisoj më kujtonte se, sido si, do bëja mirë ta tërhiqja, ta mbyllja derën…

Nuk tha asgjë të tillë, por unë pikërisht ashtu bëra.

Dera e ballkonit, e qelqtë, mu bind pa zhurmë, edhe më urtë se unë që tashmë duhet të mendoja se si do t'i shpjegohesha tim biri, pa e bërë merak atë, siç mua vet dikur nuk do doja të më bënin merak për "mamanë time".

Duke hyrë në dhomën e ndjenjës, u rreka të gjeja fjalët e duhura që asnjë boshësi momenti, asnjë dilemë, të mos përcillej ndryshe, se në fund të fundit, ajo që meditonte pa zë në ballkon ishte mami i vet, nëna e tij, jo veç bashkëshortja ime, siç 'mamaja ime' dikur ishte gruaja e tim-eti, por jo 'mamaja e tij'.

Ndonjëherë, e kapja veten duke imituar tim-At, sado dështueshëm. Ende ishim në rritje e sipër, kur ai na thoshte: "Mua do më doni se s'bën, por ju duhet të doni mamanë tuaj së pari…!"

Receptori, filli i të cilit nga ana tjetër çonte tek biri, ende prehej mbi komo. Iu qasa, dyshues në aftësinë e telave për ta përcjellë këto gjendje ndjesish në delikatesë marrëdhëniesh njerëzore që, edhe pse përsëriteshin e përsëriteshin përjetësisht, po aq përjetësisht nuk qartësoheshin dot veç përmes fjalëve.

Po, mund t'i thosha edhe tjetër gjë, të bëja ndonjë shaka nga ato që ynë bir të kuptonte gjithçka duke i thënë vetëm diçka, kur ndjeva se pas shpine dera e ballkonit po hapej. Ajo bëri shenjë se, megjithëse pa dilemë një minutë më parë mund të kishte qenë diku tjetër, kush e di ku, përmes atyre energjive që në fakt besohet se janë thelbi i qenies sonë, prej ku s'mund të ishte për askënd tjetër këtu në tokë, megjithatë pra, ajo ishte gati të fliste…me birin e Saj!

Nuk më ishte e nevojshme të ngjyrosja fjalët, pretekst meditativ s'mund të kishte, paqartësi distance, aq më shumë kur kjo dilemë në të vërtet ishte marrë me mend prej meje, në asnjë moment prej saj.

U mbështeta në divanin përballë, për ta dëgjuar e vështruar e shijuar atë shfaqje që kurrë e kurrkund në ndonjë skenë s'ishte luajtur dot, edhe pse tashmë po besoja se kjo skenë s'mund të mos kishte ndodhur edhe mes meje dhe mamasë sime, dikur…

SHQIPTARËT JANË KLIENTËT MË TË MIRË

"Albanian Post": Jeni në biznes për një kohë të gjatë si e vlerësoni komunitetin shqiptar, klientët tuaj?

Mahmud Şiringül: Komuniteti shqiptar, të gjithë shqiptarët janë vëllezërit e mi, janë konsumatorët dhe klientët më të mirë, më të edukuar, më të respektuar. Shqiptarët ngado që janë janë miq të mirë dhe klientë të nderuar. Unë dhe stafi im i konsiderojmë si një familje. Jemi me ta dhe ata janë me ne. Mundohemi gjithnjë tu plotësojmë kërkesat në rritje që ata kanë për ushqimet. Ushqimet, produktet, materialet e tjera, të gjitha ato që i duhen konsumatorit janë preopkupimi ynë. Ne i njëhim kërkesat. Ne njohim komunitetet dhe vlerat e tyre në rritje. Kërkesat na bëjnë të kërkojmë më shumë, kështu Hilal Food është një qendër e madhe dhe mjaft në shërbim të të gjithëve.

"Albanian Post": Si e mendoni të ardhmen e komunikimit klientë dhe shërbim? Kështu që do të ketë një punë më të madhe brenda gjashtë muajve deri në një vit, do të jetë më shumë punë. Çfarë mendoni se do ta bëjë atë? A do të jetë thjesht në kërkim të produktit? A do të kemi raftet plot?

Mahmud Şiringül: ne jemi gjithnjë pranë klientëve. Gjithnjë e konsiderojmë atë parësorin. Shërbejmë, ndihmojmë dhe angazhohemi. Unë mendoj se kemi shumë punë për të bërë. Dhe ky është përshpejtimi i angazhimit tonë për të cilin po flisnim. Shkalla që ndikon në vend, komunitetet - kjo do të jetë e ndjeshme. Kërkesa e përgjithshme do të jetë më e madhe. Unë mendoj se një përqindje më e lartë e kësaj do të shkojë në produktet ushqimorë, pjesërisht sepse ushqimi do të bëhet më i kërkuar pas kësaj, dhe ana e tyre jo-ushqimore do të forcohet. Dhe ne e dimë që do të ketë një kalim të madh në procese të tjera. Dhe kështu pjesa që është në dispozicion për këto kërkesa na bën të obligohemi dhe të garantojmë si gjithnjë cilësi dhe efikasitet. Unë mendoj se kjo i paraqet realitetit një çështje reale nga ana shoqërore nëse ata vetëm e lejojnë atë të ndodhë, apo nëse duhet të ofrojnë mbështetje në një farë mënyre. Dhe nëse e mbani mend, unë e preka atë në mjaft biseda të lira me Ju. Por përsëri, nëse kërkimi më i madh ndodh në gjashtë-dymbëdhjetë muajt e ardhshëm, sesa në pesë vitet

e ardhshme, atëherë do të ketë ndikime shoqërore për t'u trajtuar. Direkt në Mbretërinë e Bashkuar ka tre milion njerëz nën ombrellën e Produktit të Shitjes me pakicë, ne prisnim që të ulej me 30 përqind deri në vitin 2025. Por do të jetë më shumë dhe më mirë.

"Albanian Post": Sa kuptim do të ketë për blerësit që të fillojnë të investojnë në një aftësi reale të ofrimit në kërkesa të tjera? Apo ka të bëjë më shumë produkt-vlerësim të kërkesave, nëse në të vërtetë pandemia e ka shtruar këtë si problematikë?

Mahmud Şiringül: Investimi është me disa produkte. Për shembull somborkat merren direkt nga fushat e Kosovës, se ato pëlqehen. Kështu me mjaft produkte shqiptare që i kemi tejet origjinale. Kjo është ajo ku unë mbroj angazhimet dhe planet e mia. Përputhja e saktë e furnizimit të kërkesës në MB nuk është problematike për momentin, sepse ne negociuam shumë heqje të ligjit të konkurrencës dhe kredite nga Qeveria e MB. Dhe quo pro quo për këtë ishte që supermarketet të kujdeseshin për njerëz të prekshëm dhe, për këtë arsye, ata u kanë caktuar mjaft nga kapaciteti i miljes së tyre të fundit njerëzve që normalisht nuk do të ishin blerësit e tyre në internet. Unë mendoj se kur të dalim nga ajo fazë, ekziston kërkesa nga një demografi më e lartë që do të paguajë siç duhet për shpërndarjen, dhe unë mendoj se supermarketi ynë do të ketë mendjen t'i shërbejë ato në një nivel akoma më të lartë. Për demografinë më të ulët, nuk jam plotësisht i sigurt se në cilën mënyrë do të shkojnë dhe nuk do të jetë një përvojë dixhitale. Nuk jam i sigurt se në çfarë mase ata vazhdojnë me këtë rutinë të re të blerjeve të shportave të mëdha një herë në javë, e cila është mënyra se si njerëzit blinin, ose nëse ata do të kthehen në llojin e sjelljes pas krizës financiare të përdorimit të asaj kohe për të blerë për pazaret dhe të paturit e një repertori shumë më të gjerë rreth zbritësve. Nuk jam i sigurt se ku do të vendoset ky ekuilibër, por siç e përmenda, mendoj se dyqanet e mëdha të kutive janë sigurisht shumë më konkurruese se sa ishin, kështu që ata janë në një vend më të mirë për t'i mbajtur ata klientë pas kësaj. Por garancia jonë si supermarket për të gjitha komunitetet dhe për shqiptarët është të mbajmë çmimet reale dhe të kënaqim me cilësinë e produktit.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT
HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre
HILAL FOOD CENTRE
حلال
HALAL
INTERNATIONAL SUPERMARKET
318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059
VEAL SPECIAL OFFER
INDIAN HEAD
Old Fashioned
STONE GROUND
WHITE
Halal
Gulasch
Beef goulash
KLAS
SARAJEVO
Zlatni
Govedi Narezak
TETOVA ARY
VITA BONOR
lane
GROUND BISCUITS
VEGETA
All Purpose Seasoning
PODRAVKA
slatka paprika
ARGETA
Chicken
Halal